



Komuna Guri i Zi



PLANI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE URBANE, KOMUNA GURI I ZI

Financuar nga: InterCooperation Shqipëri
Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
Përgatitur nga: Komuna Guri i Zi
Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit)

Maj 2009



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

dldp
decentralisation and local
development programme

I. HYRJE.....	3
1.1 QËLLIMI I HARTIMIT TË PMMU (PLANI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE URBANE).....	3
1.2 OBJEKTIVAT E HARTIMIT TË PMMU (PLANI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE URBANE)	3
II. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PMMU.....	4
2.1 NISMA PËR NJË PROÇES ME PJESËMARRJE:	4
2.2 PËRCAKTIMI I DIAGNOZËS PARAPRAKE	5
2.3 IDENTIFIKIMI I SKEMAVE POTENCIALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE	5
2.4 HARTIMI I DOKUMENTIT FINAL	6
2.5 PREZANTIMI I SKEMËS NË GRUPIN E PËRFAQESVE TË KOMUNITETIT NË KOMUNËN GURI I ZI	6
2.6 MIRATIMI LIGJOR:	6
III. SKEMA E PROPOZUAR E MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE.....	7
IV. SKEMA E PROPOZUAR PËR KOMUNËN GURI I ZI.....	10
4.1 GJENDJA AKTUALE E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT NË KOMUNËN GURI I ZI	10
4.1.1 Gjenerimi i mbetjeve të ngurta.....	10
4.1.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta.....	11
4.1.3 Depozitimi i mbetjeve të ngurta	11
4.2 MASAT EMERGJENTE DREJT PËRMIRËSIMIT SË GJENDJES SË MBETJEVE URBANE	12
4.2.1 Pastrimi i zonave të vjetra të hedhjes së mbeturinave urbane	13
4.3 ANALIZIMI I SKENARËVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	15
4.3.1 Skenari i parë : Kontenierë metalikë me kapacitet 1.1 m ³ , makinë teknologjike dhe depozitimi në landfillin rajonal në Bushat.....	16
4.3.2 Skenari i dytë: Pika të hapura grumbullimi, makinë e hapur dhe depozitim në landfillin rajonal Bushat	21
4.3.3 Skenari i tretë: Pika të hapura grumbullimi dhe makinë e hapur shkarkimi i mbetjeve në vend-depozitimin aktual	22
4.4 PËRCAKTIMI I TARIFËS SË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	24
4.4.1 Llogaritja e tarifës sipas skenarit të parë	24
4.4.2 Llogaritja e tarifës sipas skenarit të dytë	26
4.4.3 Llogaritja e tarifës sipas skenarit të tretë	27
4.5 STRUKTURA ORGANIZATIVE E PROPOZUAR PËR ZBATIMIN E PMMU	29
4.6 ZBATIMI I SKEMËS SË MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE NË KOMUNËN GURI I ZI	30
4.7 NJE VESHTRIMI PERGJITHSHEM MBI MBETJET E VEÇANTA DHE TRAJTIMIN E TYRE	31
4.8 PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT TË SKEMËS SË PROPOZUAR	34
4.8.1 Treguesit e rezultateve për shërbimin e pastrimit të mbeturinave urbane:.....	35
4.9 PLANI PËR NDËRGJEGJËSIMIN DHE EDUKIMIN QYTETAR.....	36
V. KONKLUZIONE	39
VI. REKOMANDIME	42
VII. ANEKSE	44
7.1 ANEKS 1: PAMJE NGA PROÇESI ME PJESËMARRJE I HARTIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE URBANE	44
7.2 ANEKS 2: HARTA E SKEMËS SË PROPOZUAR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE DHE VENDDEPOZITIMIT TË MBETURINAVE.....	46

I. Hyrje

Gjatë Dhjetorit 2008 e në vijim komuna Guri i Zi është angazhuar në nismën për hartimin e Planit të Menaxhimit të Mbeturinave Urbane si dokumenti strategjik i cili do të mundësojë përmirësimin e kushteve të mjedisit për këtë komunë duke prezantuar për herë të parë një skemë të menaxhimit të mbeturinave urbane në bazë të së cilës do të ofrohet dhe shërbimi i ri i grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbeturinave për këtë komunë.

Nevoja për hartimin e një plani menaxhimi vjen si rrjedhojë e një mungese të gjatë në kohë të këtij shërbimi ndaj komunitetit, gjë e cila ka çuar në përkeqësimin e kushteve mjedisore, ndotjen e tij në vazhdimësi, premisa për përkeqësimin e higjienës dhe shëndetit publik apo individual.

Në këtë kuadër, komuna me mbështetjen e Inter-Cooperation Shqipëri dhe asistencën e Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit) ndërmoi iniciativën e përgatitjes së planit të menaxhimit të mbeturinave nëpërmjet procesit me pjesëmarrje të komunitetit, administratës vendore dhe grupeve të interesit, duke u bazuar në rezultatet të nxjerra nga studimi i vlerësimit paraprak, i cili është përfunduar në muajin Tetor 2008.

1.1 Qëllimi i hartimit të PMMU (Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Urbane)

- Qëllimi i kësaj nisme është përmirësimi i ofrimit të shërbimit lidhur me mbetjet urbane nëpërmjet zhvillimit të instrumentave të nevojshëm për të përmirësuar cilësinë e kushteve të jetesës për qytetarët e komunës Guri i Zi në këndvështrimin e kushteve të shëndetit dhe mjedisit urban.

1.2 Objektivat e hartimit të PMMU (Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Urbane)

- Sigurimi i një skeme efektive të menaxhimit të mbetjeve urbane
- Finalizimi i përlllogaritjes së kostos së shërbimit nëpërmjet identifikimit të një analize efektive të kostove dhe përfitimeve për skemat e mundshme alternative si edhe sigurimin e e vlerësimit të kostos lidhur me ndërhyrjen për përmirësimet e situatës ekzistuese
- Rritja e kapaciteteve organizative dhe burimeve njerëzore të komunës në lidhje me efektivitetin e procesit për menaxhimin e mbetjeve
- Mobilizimi i komunitetit vendas në proceset me pjesëmarrje lidhur me vendimarrjen përgjatë planifikimit dhe përgatitjes së dokumentit të Planit të Menaxhimit për Mbeturinave Urbane (PMMU)

II. Metodologjia e hartimit të PMMU

Metodologjia e hartimit të këtij plani të menaxhimit të mbeturinave urbane u bazua në filozofinë e proceseve me pjesëmarrje duke marrë në konsideratë përfshirjen në të e të gjithë aktorëve lokalë të interesuar por edhe përgjegjës për zbatimin e mëtejshëm të këtij plani. Gjithashtu metodologjia përfshiu komponentë të vlerësimit organizativ, teknik dhe financiar të cilët janë faktorë përcaktues të propozimit për PMMU.

2.1 Nisma për një proces me pjesëmarrje:

Me qëllimin e realizimit të një procesi me pjesëmarrje si fillim u ngrit grupi i punës në institucionin e komunës me përfaqësues të zyrës së shërbimeve, zyrës së ndihmës ekonomike dhe tatim-taksave, punonjës të qendrave shëndetësore të fshatrave Guri i Zi dhe Juban, kryepërgjegjës, përfaqësues të këshillit vendor të kësaj komune. Grupi i punës u drejtua nga kryetari i komunës Guri i Zi, Z. Broz Marku përgjatë takimeve të realizuara në komunë.

Në të njëjtën kohë u zhvilluan takime me përfaqësues të komunitetit të fshatrave të kësaj komunë ku u përfshinë qytetarë pa dallim të interesave, bindjeve politike, shtresave social ekonomike, fesë, gjinisë.

Përgjatë një periudhe kohore 2 mujore u realizuan takime periodike, prezantime të ecurisë së punës si dhe realizimi i vizitave dhe matjeve në terren për komponente të vecanta të skemës të cilët do të trajtoheshin në vijim në këtë dokument. Dokumenti i PMMU u diskutua në grupin e gjerë të qytetarëve të komunës së Gurit të Zi për rekomandime përfundimtare dhe aprovim.

Grupi i punës i ngritur pranë komunës Guri i Zi për hartimin e planit të menaxhimit të mbeturinave urbane përbëhet nga:

- | | |
|---------------------------------------|---------------------------|
| ➤ Kryetari i komunës | Z. Broz Marku |
| ➤ Përgjegjës i zyrës së tatim taksave | Z. Alfred Haxhari |
| ➤ Inspektore e zyrës së financës | Zj.Ardiana Marku |
| ➤ Drejtoresha e qendrës shëndetësore | Zj.Emona Mëhilli (Marubi) |
| ➤ Anëtar i këshillit lokal të komunës | Z.Ferd Ndreka |
| ➤ Kryeplaku i fshatit Guri i Zi | Z. Ëngjell Hila |
| ➤ Kryeplaku i fshatit Juban | Z.Marin Ndoci |

Qëllimi kryesor i ngritjes së këtij grupi konsistoi në diskutimin dhe bashkëpunimin me ekspertët e Co-PLAN përgatitjen e skemës së re të mbledhjes së mbeturinave dhe menaxhimit të saj duke përfshirë sigurimin e informacionit dhe mbledhjes së të dhënave, analizën dhe përpunimin e skenave të mundshme lidhur me gjetjen e skemës më të përshtatshme të mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve si dhe forcimin e aftësive të tyre mbi proceset e menaxhimit të mbetjeve apo çështje të tjera të organizative të komunës.

2.2 Përcaktimi i diagnozës paraprake

Përpara hartimit të planit ngrupi i Co-PLAN në bashkëpunim me komunën realizoi një vlerësim mjedisor paraprak të situatës ekzistuese në lidhje me gjendjen e mbeturinave urbane në komunë dhe shërbimin ekzistues të pastrimit. Ky proces përfshiu hapat si më poshtë vijon:

- Një studim të stafit aktual të komunës, i cili është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ofrimin e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave duke përfshirë qëndrimet, kompetencat, ekzistencën e strukturave menaxhuese etj...
- Evidentimin e kuadrit ligjor dhe mekanizmave ligjorë ekzistues lidhur me menaxhimin e mbeturinave
- Zhvillimi i informacionit bazuar mbi evidencat rreth sasive dhe përbërjes së mbeturinave urbane në komunë. Aktualisht ky informacion është i bazuar në vlerësime të përafërta duke iu referuar standartit kombëtar mbi normën e gjenerimit të mbetjeve. Gjithsesi një vlerësim i saktë për volumet dhe përbërjen e mbeturinave mbetet një nga hapat kyç për dizenjimin e një sistemi menaxhimi të tyre
- Kryerja e një vlerësimi të detajuar mbi mekanizmat për transferimin e mbetjeve nga prodhuesit deri në venddepozitim duke përfshirë cilësinë, shpërndarjen dhe përcaktimin e numrit të pikave të grumbullimit si edhe cilësinë dhe numrin e makinerivë përkatëse.
- Rishikimi i situatës ekzistuese të venddepozitimit aktual dhe shkalla e ndotjes në zonat përreth
- Vlerësimi i situatës lidhur me venddepozitimit e ri rajonal të propozuar në Bushat duke përfshirë llogaritjen e shpenzimeve të pritshme të shërbimit me referencë rritjen e mundshme të kostove të transportit apo kostove të tjera
- Rishikimi i plotë i procedurave ekzistuese të menaxhimit financiar në komunë duke përfshirë një vështrim mbi sistemin aktual të kostove lidhur vetëm me mbeturinat urbane

2.3 Identifikimi i skemave potenciale të menaxhimit të mbetjeve

Për të identifikuar skemën më të përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave u përpunuan 3 skema alternative të mbledhjes, transportit dhe venddepozitimit të mbetjeve me qëllimin krahasimin e tyre, duke u bazuar në tarfën përkatëse të shërbimit dhe koston totale të tij. Hapat e ndjekura për këto analiza vijnë si më poshtë:

- Rrugët e mbledhjes së mbeturinave – itinerarët e grumbullimit, frekuenca dhe distance mes fshatrave duke patur parasysh se secili prej këtyre komponentëve mund të rrisë koston e transportit drejt venddepozitimit final;
- Vendndodhja e kazanëve në zonë dhe volumi i kërkuar. Kjo gjë është llogaritur duke konsideruar edhe vendndodhjen e venddepozitimit aktual dhe atij të ri Identification the best alternative of ëaste collection.
- Evidentimi i llojeve të ndryshme të pikave të grumbullimit (të hapura, të mbyllyra, me kazanë metalikë etj...)

- Përcaktimi i skemës së re organizative të komunës lidhur me njësinë e menaxhimit të mbeturinave
- Analiza e kostove financiare për secilën skemë potenciale, fizibiliteti dhe rrugët e mundshme të financimit të shërbimit

2.4 Hartimi i dokumentit final

Hartimi i dokumentit final përmban komponentët e mëposhtëm të cilët në mënyrë të detajuar janë analizuar në brendësi të dokumentit si më poshtë vijon:

1. Itinerari i mbledhjes së mbeturinave dhe frekuencat përkatëse të shërbimit
2. Përcaktimi i vendndodhjes të pikave të grumbullimit në komunë
3. Mënyra e mbledhjes së mbeturinave në secilën zonë të propozuar për zbatimin e skemës
4. Struktura e propozuar organizative e ndërmarrjes për shërbimin e pastrimit në komunë
5. Burimet dhe kostot financiare të nevojshme për skemën e propozuar
6. Investime e nevojshme të shtuara për të ardhmen për të mbështetur përmirësime të mëtejshme të skemës së menaxhimit të propozuar
7. Plani për ndërgjegjësimin dhe edukimin qytetar lidhur me komponentët e skemës
8. Plani i monitorimit dhe vlerësimit për skemën e propozuar

2.5 Prezantimi i skemës në grupin e përfaqësuesve të komunitetit në komunën Guri i Zi

Pas hartimit të dokumentit final procesi i punës për miratimin dhe fillimin e zbatimit të skemës vijon me prezantimin e saj tek të gjithë aktorët vendorë të interesuar dhe përgjegjës për mbarëvajtjen e skemës në të ardhmen me qëllim garantimin e suksesit gjatë zbatimit dhe sigurisë për shtrirje apo zgjerim në zona të tjera duke lehtësuar qëndrueshmërinë e saj.

Prezantimi i dokumentit për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në grupin e gjerë të qytetarëve përcakton dhe një lloj kontrate mes autoriteteve vendore dhe popullatës vendase si palët kryesore në angazhimin për një zbatueshmëri të skemës.

2.6 Miratimi ligjor:


Dokumenti i PMMU do të jetë subjekt për prezantim dhe diskutim në këshillin vendor të komunës dhe më pas të gjejë miratimin ligjor. Kjo për arsye se komponentë të caktuar dhe mjaft të rëndësishëm të planit lidhen në mënyrë të drejperdrejtë me miratimin e buxhetit të komunës si dhe strukturës organizative nga organi më i lartë vendor siç është këshilli vendor.

III. Skema e propozuar e menaxhimit të mbetjeve urbane

Megjithëse bashkive dhe komunave ligji 8652 (31.7.2000) mbi “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i jep përgjegjësinë, mes detyrimeve të tjera, për mbledhjen transportin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta, aktualisht në komunën Guri i Zi nuk ekziston ndonjë strukturë përgjegjëse për kryerjen e këtij shërbimi apo ndonjë skeme për menaxhimin e mbetjeve urbane. Shërbimi i pastrimit në Komunën Gur i Zi është kufizuar vetëm në mbledhjen e mbeturinave urbane dhe shkarkimin e tyre në vend depozitimit e pakontrolluar pranë urës së Kirit.

Ndërkohë Komuna Gur i Zi është njëra nga njësitë e qeverisjes vendore në rajonin e Shkodrës, e cila është e përfshirë në Programin e Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal, të financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe të zbatuar nga Intercooperation Albania me qendër në Shkodër. Në kuadër të këtij programi komuna është asistuar në hartimin e skemës së menaxhimit të mbetjeve urbane, vlerësimin e kostos së shërbimit, përcaktimin e tarifave për banorët, bizneset dhe institucionet si dhe vlerësimin e përafërt të kostos së pastrimit të zonave të vjetëra ku janë hedhur në mënyrë të pastudiuar mbeturinat.

Proçesi i menaxhimit të mbetjeve urbane për komunën e Gurit të Zi, ashtu sikurse edhe për komunat e tjera dhe bashkitë në vend përbëhet nga komponentët siç paraqiten skematikisht në diagramën e mëposhtme:



Duhet theksuar se në skemën e mësipërme për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake/komune ka edhe shumë elemente të tjerë teknik më të detajuar që lidhen me minimizimin e mbetjeve urbane, ripërdorimin apo edhe riciklimin e tyre. Megjithatë kjo skemë është aktualizuar për kushtet në të cilat

ndodhet komuna e Gurit të Zi, duke i dhënë mundësinë autoriteteve vendore për të pasur një skemë e cila gjen zbatim në terren bazuar në kushtet ekzistuese të saj me synimin për të konsoliduar më tej kapacitetet e saj organizative, teknike dhe financiare për përmirësimin e shërbimit të pastrimit deri në arritjen e standarteve bashkëkohore.

Për të aplikuar këtë skemë mjaft e rëndësishme ka qënë marrja në konsideratë e faktit që komuna do të aplikojë shërbimin e pastrimit për herë të parë gjatë periudhës së post-komunizmit. Deri më sot ky shërbim nuk është ofruar nga komuna dhe për rrjedhojë strukturat organizative që do të ofrojnë këtë shërbim nuk ekzistojnë në organogramën e komunës. Për më tepër gjatë takimeve periodike me përfaqësues/ekspertë të komunës është nënvizuar fakti që ndërgjegjësimi i komunitetit është një element thelbësor në funksionimin e skemës, pasi një nga sfidat e këtij plani është padyshim ndryshimi pozitiv i sjelljes së komunitetit në raport me mjedisin në tërësi dhe mbetjet në veçanti. Mungesa e gjatë prej në vite e këtij shërbimi ka reflektuar dhe një qëndrim të komunitetit më pak të angazhuar për hedhjen e mbeturinave në vendet përkatëse. Po ashtu, banorët të ndodhur përpara situatës për të vetë menaxhuar mbeturinat janë detyruar të krijojnë pika spontane të hedhjes së mbetjeve, të cilat janë jashtë kushteve teknike dhe nuk vijnë si pasojë e studimi të mirëfilltë për të gjithë procesin e trajtimit të mbetjeve.

Pikat ekzistuese të ndodhura përgjatë rrugës kryesore apo kanaleve të ujitjes janë kthyer tashmë në një burim shqetësimi si për komunitetin ashtu dhe për komunën e cila do të duhet të adresojë sa më parë këtë problem pasi situata mjedisore dhe rreziqet për ndotje dhe për shëndetin/higjenën publike janë serioze.

Po të analizojmë të gjitha hallkat e menaxhimit të mbetjeve do të shohim që përpunimi final i mbetjeve dhe elementët e menaxhimit financiar marrin një rëndësi primare. Kjo për faktin se:

- (i) komuna ende nuk ka një marrëveshje për depozitimin e mbetjeve në landfillin rajonal që po ndërtohet në Bushat, dhe për rrjedhojë është e detyruar të vazhdojë t'i depozitojë mbetjet në venddepozitimin ekzistues pranë urës së Kirit, i cili nuk kontrollohet nga kjo komunë
- (ii) aspektet financiare të kostos totale të ofrimit të shërbimit do të kushtëzojnë edhe modernizimin e shërbimit, duke marrë parasysh koston e investimeve të nevojshme si parakusht për fillimit të zbatimit (shiko skenarët e propozuar)

Komuna e Gurit të Zi është e vendosur që të ndërhyjë për të përmirësuar situatën në drejtim të shërbimit të pastrimit së komunës, jo vetëm duke menduar të ofrojë shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve të ngurta por edhe të rehabilitojë situatën ekzistuese sipas një plani për menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

Plani për Menaxhimin e Mbeturinave u hartua duke u mbështetur si në disa kriteret standarte teknike, po ashtu dhe duke marrë në konsideratë kushtet konkrete dhe mundësitë reale për një përmirësim të shërbimit të pastrimit sa më afër plotësimit të nevojave të qytetarëve shoqëruar dhe me rritjen e efikasitetit të burimeve financiare dhe njerëzore që komuna do të përdorë gjatë zbatimit të tij si në kushtet aktuale por dhe në vijim. Këto kriterë do të përdoren edhe në përcaktimin e shtrirjes graduale të shërbimit të pastrimit, të tilla si:

- numri i popullsisë
- pozicionimi gjeografik i fshatit në raport me qendër-komunën
- dendësia e popullsisë
- numri i shtëpive
- largësia e shtëpive nga njëra tjetra
- largësia e fshatit nga venddepozitimi
- ekzistenca e institucioneve apo njësive të shërbimit dhe numri i tyre përkatës
- sasia e mbeturinave të prodhuara nga kategoritë e ndryshme që gjenerojnë të tilla si familjet, bizneset apo institucionet e ndryshme
- situata e infrastrukturës fizike ekzistuese
- kostot për ndërhyrje dhe ofrim të shërbimit
- kostot për investime
- të ardhurat nga aplikimi i tarifës
- përqindja e mbulimit të kostos së shërbimit nga tarifa

Duke u nisur nga kriteret e mësipërme si dhe kapacitetin e pamjaftueshëm aktual të komunës për të përballuar ofrimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë komunën, u diskutua dhe analizua që shërbimi i pastrimit të fillojë me zbatimin e skemës në 7 fshatra e më pas të gjejë shtrirje në nivel vendor edhe në fshatra të tjerë të saj. Në këto kushte komuna ka evidentuar si nevojë të menjëhershme hartimin e planit të menaxhimit të mbeturinave si model për t'u zbatuar në fshatrat Guri i Zi, Juban, Vukatanë, Rrenx, Gajoll, Gajtan dhe Rragam.

Skema e propozuar më sipër ashtu edhe siç është konkluduar pas analizave të kryera bazuar edhe në kapacitetet ekzistuese të komunës si financiare ashtu dhe njerëzore dhe logjistike do të jetë në funksion për këto fshatra.

Kjo skemë propozon të fillojë zbatimin e punës në terren pra ofrimin e shërbimit të pastrimit në muajin Qershor 2009. Ndërkohë, plani parashikon shtrirjen e shërbimit edhe për disa fshatra të tjerë të komunës në të ardhmen si edhe përmirësimin e tij, duke patur parasysh rritjen e te ardhurave nga vjelja e taksës dhe koston përkatëse të tij.

Përzgjedhja në vijim e fshatrave në të cilat është menduar të shtrihet skema e menaxhimit të mbeturinave është bazuar në të njëjtat kritere që përcaktuan dhe fshatrat me të cilët do të fillojë zbatimi i saj brenda vitit 2009.

Ky plan përmban në vetvete propozimet për skemën e re të grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave, trajtimin e venddepozitimit të mbeturinave, ngritjen e strukturës së ndërmarrjes së pastrim-gjellbërimit sipas shërbimeve specifike, prezantimin për ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit, mbulimin e kostos së shërbimit me rritjen e efikasitetit në menaxhim, ngritjen e një skeme monitorimi dhe shtrirjen e këtij shërbimi edhe në fshatra të tjerë në të ardhmen sipas analizave përkatëse (vitet 2009- 2013).

Plani i menaxhimit të mbeturinave përcakton rekomandimet për ndërhyrje në kohë afatshkurtër (viti 2009) si dhe një strategji për shtrirje afatmesëm (vitet 2009 – 2013).

IV. Skema e propozuar për komunën Guri i zi

Për të realizuar objektivat e saj Komuna e Gurit të Zi është mbështetur me asistencë teknike në llogaritjen e kostos së shërbimeve të mëposhtme në veçanti dhe në tërësi për hartimin e planit lidhur me zbatimin e skemës dhe propozimeve për shtrirje në fshatra të tjerë.

- (i) Rehabilitimi i gjendjes ekzistuese (pastrimi i të gjitha kanaleve kryesore kulluese në fshatrat Guri i Zi dhe Jubane dhe zonat e tjera të ndotura në pikat e hapura në këto 2 fshatra)
- (ii) Llogaritja e kostos së plotë të ofrimit të shërbimit të pastrimit në fshatrat Gur i Zi, Jubanë, Vukatanë, Rrenc, Rragam, Ganjoll, Gajtan.
- (iii) Llogaritja e tarifës së pastrimit që duhet të paguajnë kategoritë e ndryshme që e përfitojnë këtë shërbim pra banorët, bizneset dhe institucionet.

Dokumenti në vazhdim do të adresojë pikërisht llogaritjet e këtyre kostove si dhe tarifave përkatëse.

4.1 Gjendja aktuale e shërbimit të pastrimit në komunën Guri i Zi

4.1.1 Gjenerimi i mbetjeve të ngurta

Sipas të dhënave të grumbulluara, nëpërmjet intervistave dhe punës me grupin e punës, në komunë gjatë fazës së vlerësimit të shpejtë të situatës tabela e mëposhtme paraqet vlerat e gjenerimit të mbetjeve sipas popullsisë për shtatë (7) fshatrat e komunës Gur i Zi, ku do të parashikohet të ofrohet shërbimi i plotë i pastrimit.

Nr.	Fshati	Popullsia	Vlerësimi i sasisë së gjeneruar të mbetjeve të ngurta		
			kg/banor/ditë	ton/banor/vit	ton/vit
1	Gur i Zi	2507	0.599	0.219	549.03
2	Juban	2401	0.599	0.219	525.82
3	Vukatanë	1099	0.599	0.219	240.68
4	Rrenc	1097	0.599	0.219	240.24
5	Rragam	1291	0.599	0.219	282.73
6	Gajoll	558	0.599	0.219	122.20
7	Gajtan	360	0.599	0.219	78.84
Total		9313	0.599	0.219	1073.1

Në këtë komunë nuk ka të dhëna të sakta mbi normën e gjenerimit të mbetjeve urbane si dhe mbi përbërjen mercologjike të mbetjeve. Nuk ka një sistem të monitorimit të shërbimit të pastrimit pasi ky i fundit kryhet në mënyrë amatore nga një person i vetëm. Si pasojë e mungesës së peshoreve në pikat e vend depozitimit final të mbetjeve sasia në ton e mbetjeve urbane të gjeneruara në vit, raportohet

mbi bazën e rrugëve të kryera nga makina (volumi i makinës) të larguara në vit. Gjithashtu norma e gjenerimit është marrë nga raporti vjetor "Mbi Gjendjen e Mjedisit 2005" publikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

4.1.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të ngurta

Në këtë komunë shërbimi i pastrimit kryhet "pothuaj" mbi baza vullnetare nga një person i vetëm i cili merr një pagë prej 18.000 lek/muaj. Ky shërbim ofrohet vetëm në fshatrat Gur i Zi dhe Juban ku janë vendosur rreth 18 pika grumbullimi (kosha të vegjël) të vendosura kryesisht në sheshet kryesore të fshatrave. Mbledhja e mbeturinave kryhet përgjatë aksit të rrugës kryesore dhe këtë shërbim e përfitojnë vetëm ato biznese që ndodhen të vendosura në këtë aks rrugor. Ndërkohë banorët i transportojnë mbetjet me karroca dore dhe i hedhin ku munden sa më larg banesave të tyre. Për rrjedhojë vend depozitimet ilegale dhe grumbuj mbetjesh mund të evidentosh ngado nëpër komunë.

Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve kryhet nga një person i vetëm një herë në dy javë. Ai ka në pronësi të tij një makinë të hapur, tejet të amortizuar (viti i prodhimit 1986) 3ton e tipit Om.



4.1.3 Depozitimi i mbetjeve të ngurta

Mbeturinat largohen një herë në dy javë dhe transportohen në venddepozitimin që ndodhet 8 km larg qendrës së komunës. Aktualisht ky vend depozitim fillimisht ka nevojë të vihet nën kontroll (të rrethohet) dhe më pas të pushojë së funksionuari si i tillë. Komuna Gur i Zi ka një tjetër alternative për të depozituar mbetjet e prodhuara në landfillin sanitar rajonal që po ndërtohet në Bushat të Shkodrës në një distancë prej 17,23 km.



4.2 Masat emergjente drejt përmirësimit së gjendjes së mbetjeve urbane

Si pasojë e mungesës së ofrimit të shërbimit të pastrimit nga ana e komunës, banorët i kanë shkarkuar mbetjet e tyre sa më larg të mundën banesave të tyre dhe kryesisht pranë përrenjeve apo kanaleve të shkarkimit të ujrave të bardha kulluese. Në këtë mënyrë banorët janë munduar t' a largojnë problemin nga banesat e tyre duke krijuar të tjera probleme mjedisore dhe shëndetësore për komunitetin e zonës.





Si rezultat jo vetëm që këto kanale janë të tejmbushura me mbeturina po shpesh herë edhe të bllokuara nga to, sidomos në rastet kur mungon pjerrësia. Për më tepër shpesh herë pas reshjeve të shumta, uji përmbyt sipërfaqe të tëra si pasojë e bllokimit të këtyre kanaleve kulluese. Rrjedhojë e kësaj panoramë janë problemet e shumta mjedisore që shoqërojnë ndotjen e këtyre ujërave si dhe mundësite e përhapjes së sëmundjeve të shumta infektive për popullatën vendase. Në të njëjtën kohë mbeturinat janë të hedhura në mënyra sporadike dhe të pakontrolluar edhe përgjatë rrugës kryesore në disa hapësira si p.sh. anës mureve të vjetra, rrugëve ndarjeve mes godinave të vjetra apo shtepive apo në zona të hapura përreth kanaleve që përshkruajnë fshatrat. Kryesisht fshatrat Guri i Zi dhe Juban kanë një përqindje më të lartë të këtyre zonave pasi ata janë dhe fshatrat më të mëdhenj të komunës si për nga numri i popullsisë ashtu dhe i institucioneve dhe bizneseve që operojnë dhe gjenerojnë si rrjedhojë më shumë mbetje urbane.

4.2.1 Pastrimi i zonave të vjetra të hedhjes së mbeturinave urbane

Duke u nisur nga fakti se zonat më problematike që zënë dhe pjesën më të madhe të zonave ku hidhen në mënyrë sporadike dhe të pakontrolluar mbeturinat urbane janë kanalet kulluese, të cilat e kanë humbur funksionin e tyre të dikurshëm për shkak të bllokimit nga mbetjet e hedhura në to përgjatë pothuajse 18 viteve, por edhe hapësira të tjera publike të cilat ndodhen në afërsi të tyre apo përgjatë

rrugës kryesore, llogaritja për pastrimin e tyre do të konsistojë pikërisht në matjen e kostove për rehabilitim të këtyre zonave. Për të përcaktuar saktë sasinë e mbeturinave që janë depozituar nëpër kanalet kryesore të fshatrave në komunën e Gurit të Zi do të ishte e nevojshme kryerja e matjeve të shumta përgjatë gjithë kanaleve kulluese apo zonave të tjera të vjetra ku hidhen mbetjet, si dhe norma e saktë e hedhjes ditore apo edhe përbërja merceologjike e mbetjeve urbane. Duke qënë se gjendja paraqitet më problematike në fshatrat Guri i Zi dhe Juban (këto dy fshatra janë marrë në konsideratë pasi janë fshtatrat më të mëdhenj të komunës, me numrin më të lartë të popullsisë, institucioneve dhe bizneseve operuese, për rrjedhojë dhe me përqëndrimin më të lartë të gjenerimit dhe hedhjes së mbeturinave në këto zona), komuna do të llogarisë kostot përkatëse për pastrimin e kanaleve përkatës në këto dy fshatra.

Aktualisht pas diskutimit edhe me ekspertët e komunës si dhe duke u nisur nga saktësia e llogaritjes që kërkohet është bërë një vlerësim paraprak i sasisë së mbetjeve urbane që janë të depozituara në këto kanale dhe hapësira të tjera publike përreth të cilat paraqesin nevojën për ndërhyrjen rehabilituese përpara fillimit të ofrimit për shërbimin e ri të grumbullimit të mbeturinave urbane.

Në bazë të supozimeve të mëposhtme duke iu referuar dhe disa parametrave të matura në terren së bashku me grupin e punës kemi:

- (i) Gjatësia mesatare e kanaleve rreth 50 m
- (ii) Gjerësia mesatare e kanaleve 1 m
- (iii) Thellësia mesatare e kanaleve 0,5 m
- (iv) Shtresa e depozituar e mbetjeve të ngurta në kanal rreth 0.25 m
- (v) Numri i kanaleve të evidentuara 8

Është llogaritur që sasia totale e mbetjeve të depozituara në këto kanale është rreth 100 m³, duke patur parasysh edhe një përfshirje të mbeturinave të tjera që do të hiqen nga zonat e vjetra si psh përgjatë rrugës kryesore apo në afërsi të këtyre kanaleve.

Gjithashtu supozohet se komuna për të kryer shërbimin e rehabilitimit të zonës do të marrë me qera një mjet të hapur si dhe do të punësojë për të kryer këtë shërbim 4 punëtorë për një periudhë kohore prej dy muaj.

Tabela e mëposhtme jep një pamje më të detajuar të llogaritjes së kostos së përafërt të rehabilitimit të gjendjes ekzistuese:

1.1	MATERIALE	COPE	ÇMIMI/NJËSI	TOTALI
1.1.1	KARROÇA DORE	2	7,200	14,400
1.1.2	LOPATA DORE	4	500	2,000
1.1.4	ÇIZME	4	600	2,400
1.1.5	DOREZA	4	200	800
1.1.6	PËRPARËSE	4	2,000	8,000
1.1.7	GËLQERE	200	10	2,000
1.1.8	KLOR	150	200	30,000
			SHUMA I	59,600
1.2	FUQIA PUNËTORE	ORË	LEKË/ORË	TOTALI
1.2.1	ORË PUNE (4 x 8 x 44)	1,408	148	208,384
1.2.2	SIGURIMET SHOQËRORE	32.0		66,683

		SHUMA II		275,067
1.3	HEQJA DHE TRANSPORTI I MBETURINAVE	M ³	LEKË/M ³	TOTALI
1.3.1	SASIA E MBETJEVE QË DO TË TRANSPORTOHEN	100	1,000	100,000
1.3.2	QERAJA E MJETIT			132,000
1.3.3	LËNDË DJEGËSE (25 LITRA/DITË)	1,100	110	121,000
1.3.4	LUBRIFIKANT (15 LITRA/DITË)	660	400	264,000
		SHUMA III		617,000
SHUMA I + II + III				951,667
1.4	SHPENZIME PLOTËSUESE	0.08		76,133
KOSTO TOTALE				1,027,800

4.3 Analizimi i skenarëve të ofrimit të shërbimit të pastrimit

Stafi i komunës Guri i Zi është i motivuar që të ofrojë shërbimin e pastrimit për shtatë fshatrat në komunë, përkatësisht Guri i Zi, Juban, Vukatanë, Rrenc, Rragam, Ganjoll, Gajtan e më pas të shtrijë këtë shërbim në gjithë komunën. Për të parashikuar dhe planifikuar në buxhet shpenzimet për ofrimin e këtij shërbimi komuna ka kërkuar asistencë për llogaritjen e kostos së plotë të shërbimit si dhe të tarifës së diferencuar të shërbimit, në mënyrë të tillë që në një periudhë të caktuar kohore, të ardhurat e gjeneruara nga mbledhja e tarifës të mbulojnë koston e ofrimit të këtij shërbimi.

Duhet të theksojmë se kosto e plotë e shërbimit të pastrimit përbëhet nga kosto operative plus koston për investime që duhen për të përmirësuar shërbimin “primitiv” të ofruar deri më tani. Në këtë raport do të analizojmë koston operative dhe koston e investimeve që nevojiten në infrastrukturën e shërbimit për sa kohë që ky shërbim do të ofrohet për herë të parë.

Objekivi i komunës është që deri në vitin 2013 kosto operative e shërbimit të mbulohet nga tarifatat që do të mbledhen nga përfituesit e këtij shërbimi (përkatësisht banorët, bizneset dhe institucionet)

Pas intervistave dhe diskutimeve me ekspertin e mbetjeve në Komunën Guri i Zi u vendos që për të gjithë fshatrat e marra në llogaritje të konsiderohen shifrat mesatare për prodhimin e mbeturinave si më poshtë paraqitur:

Sasia e gjenerimit për banor	Sasia e gjenerimit për biznese	Sasia e gjenerimit për institucionet
0.6 kg/banor/ditë	10 kg/biznes/ditë	8 kg/institucion/ditë

Shërbimi i pastrimit që do të shtrihet për shtatë fshatrat Guri i Zi, Juban, Vukatanë, Rrenc, Rragam, Ganjoll, Gajtan do të konsistojë në mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga pikat e grumbullimit (76 pika në të shtatë fshatrat së bashku) deri në landfillin rajonal të Bushatit.

Komuna ka kërkuar asistencë për llogaritjen e kostos së plotë të shërbimit sipas tre skenarëve:

- (i) shërbimi i pastrimit parashikon vendosjen e kontenerëve metalikë të rinj me një kapacitet prej 1.1 m³ si dhe blerjen e një makine teknologjike të përdorur por në kushte të mira pune dhe përfundimisht shkarkimin e mbetjeve në landfillin rajonal që po ndërtohet në Bushat. (nga pikëpamja e investimit dhe respektimit të standarteve mjedisore dhe atyre të shërbimit publik të pastrimit, ky skenar është më i dëshirueshem)

- (ii) shërbimi i pastrimit parashikon vendosjen e pikave të hapura të grumbullimit (pika betoni) si dhe blerjen e një makinë të hapur për grumbullimin e mbetjeve dhe përfundimisht shkarkimin e tyre në landfillin rajonal të Bushatit. (ky skenar për të njëjtat kritere të sipërpërmendura është skenar më pak i dëshirueshëm)
- (iii) shërbimi i pastrimit parashikon vendosjen e pikave të hapura të grumbullimit (pika betoni) si dhe blerjen e nje makine të hapur për grumbullimin e mbetjeve dhe përfundimisht shkarkimin e tyre në vend depozitimin aktual që ka komuna (ky skenar për të njëjtat kritere të sipërpërmendura është skenari më i padëshirueshëm)

Pavarësisht se është kërkuar që të aplikohet një shërbim i ri në komunë, kjo e fundit është e ndërjegjshme se ky shërbim kërkon si ngritjen e infrastrukturës, e cila nuk ekziston, ashtu edhe ngritjen e kapaciteteve brenda institucionit të komunës, të cilat janë mjaft të kufizuara si në pikëpamjen financiare, logjistike dhe burimeve njerëzore. Përsa i përket kësaj të fundit me mundësitë që ka komuna parashikon punësimin e 2 punëtorëve dhe të një shoferi si staf me kohë të plotë, ndërkohë që shërbimi i pastrimit do të ofrohet 3 herë në javë.

Megjithatë buxheti dhe të ardhurat financiare që ka komuna mbeten edhe barriera kryesore për ofrimin e shërbimit të pastrimit si edhe shtrirjen e këtij shërbimi në gjithë komunën. Është pikërisht kjo arsyeja që komuna kërkon të ketë një tablo më të qartë financiare sipas tre skenarëve të mësipërm. Është e pritshme që skenari i parë (më i dëshirueshmi) të jetë edhe skenari më i shtrenjtë për komunën, por që në të njëjtën kohë të jetë edhe skenari më mjedisor dhe më i qëndrueshëm për këtë shërbim në të ardhmen. Ndërkohë që skenari i fundit pritet të jetë edhe skenari me koston më të ulët përsa i përket faturës financiare që i duhet komunës të paguajë për të ofruar këtë shërbim dhe më pak i dëshirueshëm përsa i përket ndotjes dhe problemeve me mjedisin në vijimësi.

4.3.1 Skenari i parë : Kontenierë metalikë me kapacitet 1.1 m³ , makinë teknologjike dhe depozitimi në landfillin rajonal në Bushat

Për të përcaktuar saktë sasinë e gjeneruar të mbeturinave ditore dhe vjetore, metoda më e saktë është matja e drejtë për drejtë e peshës së tyre në ditë të caktuara të vitit. Deri më tani kjo metodë nuk është aplikuar e për rrjedhojë nuk dihet me saktësi të plotë sasia e mbetjeve të gjeneruara në një vit. Nga ana tjetër komuna nuk rezulton të ketë një regjistër të mbetjeve të prodhuara ndër vite sikurse nuk disponon edhe mjete për peshimin e mbetjeve të depozituara në vend depozitim. Akoma më tepër nga vizita në terren është konstatuar që jo të gjitha mbetjet e prodhuara shkojnë në vend depozitim, në më të shumtën e rasteve ato hidhen në kanalet e ujërave të bardha të cilat përshkruajnë dy fshatrat më të mëdhenj nga numri i popullsisë dhe shtrirja territoriale, Gur i zi dhe Juban.

Aktualisht pas diskutimit edhe me ekspertët e komunës, referuar standartit të jetës si dhe duke u nisur nga eksperiencat e vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore si dhe atyre të Ballkanit, janë përcaktuar normat e gjenerimit të mbetjeve si dhe pesha specifike e mbulimit të koston sipas burimeve të kategorive të prodhimit dhe në të njëjtën kohë sipas kategorive që përfitojnë shërbimin.

	Banorët	Bizneset	Institucionet
Sasia e gjenerimit	0.6 kg/banor/ditë	10 kg/biznes/ditë	8 kg/institucion/ditë
Pesha specifike e mbulimit	70%	28%	2%

Më tej do të vijojmë me analizën e kostove për secilin komponent të shërbimit të pastrimit si dhe me përshkrimin e të gjitha konsideratave paraprake të supozuara.

Mbledhja e mbeturinave nga pikat e grumbullimit

Shërbimi i pastrimit do të ofrohet vetëm për shtatë fshatrat Gur i Zi, Juban, Vukatanë, Rrenc, Rragam, Gajoll, Gajtan dhe më pas do të shikohet mundësia për t'u shtrirë në të gjitha fshatrat e kësaj komune. Aktualisht parashikohet që të përfitojnë këtë shërbim:

Nr.	Fshati	Nr. Banorëve	Nr. Familjeve	Nr. Institucioneve	Nr. Bizneseve
1	Gur i zi	2507	673	4	40
2	Juban	2401	624	3	21
3	Vukatanë	1099	261	4	3
4	Rrenc	1097	330	3	10
5	Rragam	1291	299	4	3
6	Gajoll	558	143	2	2
7	Gajtan	360	107	1	1
	Totali	9313	2437	21	80

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë marrë nga Komuna Gur i Zi, zyra e gjendjes civile në këtë institucion. Sasia e mbetjeve që prodhohen në një ditë është llogaritur në tabelën e mëposhtme:

Guri i Zi		kg/ditë
Banorët	2507 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	1,504
Bizneset	40 biznese x 10 kg mbeturina në ditë	400
Institucionet	4 institucione x 8 kg mbeturina në ditë	32
Gjithsej		1,936
Juban		kg/ditë
Banorët	2401 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	1,441
Bizneset	21 biznese x 10 kg mbeturina në ditë	210
Institucionet	3 institucione x 8 kg mbeturina në ditë	24
Gjithsej		1,675
Rrenc		kg/ditë
Banorët	1097 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	658
Bizneset	10 biznese x 10 kg mbeturina në ditë	100
Institucionet	3 institucione x 8 kg mbeturina në ditë	24
Gjithsej		782
Gajtan		kg/ditë
Banorët	360 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	216
Bizneset	1 biznese x 10 kg mbeturina ne ditë	10

Institucionet	1 institucione x 8 kg mbeturina ne ditë	8
Gjithsej		234
Rragam		kg/ditë
Banorët	1291 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	775
Bizneset	4 biznese x 10 kg mbeturina në ditë	40
Institucionet	3 institucione x 8 kg mbeturina në ditë	24
Gjithsej		839
Vukatanë		kg/ditë
Banorët	1099 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	659
Bizneset	3 biznese x 10 kg mbeturina në ditë	30
Institucionet	4 institucione x 8 kg mbeturina në ditë	32
Gjithsej		721
Ganjolle		kg/ditë
Banorët	558 banorë x 0.6 kg mbeturina/ditë	353
Bizneset	2 biznese x 10 kg mbeturina në ditë	20
Institucionet	2 institucione x 8 kg mbeturina në ditë	16
Gjithsej		389
Totali i gjenerimit		6,576

Pra përfundimisht mund të themi që sasia e mbeturinave të krijuara në një vit në të shtatë fshatrat së bashku është: 6,576 kg/ditë x 365 ditë = 2400 ton/vit

Skema e propozuar për shtatë fshatrat që do përfitojnë shërbimin e pastrimit, propozon shpërndarjen e 76 pikave të grumbullimit të mbeturinave, 24 Gur i Zi, 14 Juban, 11 Vukatanë, 8 Rrenc, 10 Rragam, 5 Ganjoll, 4 Gajtan, (nga një kontenier metalik për çdo pikë grumbullimi) duke mbuluar pjesën më të madhe të territorit që i ofrohet shërbimi (përsa kohë që aksesit i rrugëve e lejon një gjë të tillë). Pasi të fillojë funksionimi i skemës, komuna duhet të riorganizojë shpërndarjen dhe kompozimin e kazanëve duke marrë në konsideratë koeficientin e shfrytëzimit të kontenierëve metalikë, me qëllimin final rritjen e efektivitetit dhe uljen më tej të kostos së shërbimit. Në të njëjtën kohë përveç këtij numri kontenierësh metalikë për zbatimin e kësaj skeme të propozuar do të jetë e nevojshme dhe sigurimi i një fondi rezervë kontenierësh metalikë, të cilët do të shërbejnë në të ardhmen për të zëvendësuar në rast të ndonjë dëmtimi të mundshëm apo në rast të nevojës për shtim të numrit të kazanëve metalikë në zona të veçanta. Numri i kontenierëve metalikë të propozuar për rezervë parashikohet të jetë 24 copë, duke siguruar një parashikim shpërndarje sipas kriterëve të mëposhtme përkatësisht Guri i Zi 5, Juban 5, Vukatanë 4, Rrenx 4, Rragam 4, Ganjoll 1, Gajtan 1. Ky parashikim është subjekt i ndryshimit në varësi të progresit të skemës pas fillimit të zbatimit të saj në këto fshatra.

Për vendosjen dhe vendndodhjen e 76 pikave të grumbullimit të mbeturinave u hartuan shtatë hartat përkatëse për fshatrat duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Densiteti i popullsisë
- Distanca nga një pikë në tjetrën të mos e kalojë kufirin e 60-70 m
- Aksesit rrugor dhe përshtatja me infrastrukturën/hapësirat publike
- Siguria për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e kazanëve
- Krijimi i mundësisë për një sistem standart të grumbullimit të mbeturinave.

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Urbane, Komuna Guri i Zi

Nisur edhe nga interesi i komunës në këtë skenar është llogaritur vendosja e kazanëve metalikë me volum 1.1 m³ duke qënë se komuna synon të fusë në përdorim edhe një makinë teknologjike.

Llogaritja për numrin e kazanëve metalikë si edhe shpërndarja e tyre u bazua mbi numrin e familjeve si dhe duke respektuar normativën (sipas studimeve të bëra për të shfrytëzuar me efikasitet kontenierët metalikë, llogaritet që një kontenier t'u shërbejë rreth 25 deri 30 familjeve, në varësi të dendësisë së shtëpive, pallateve etj), por duke marrë në konsideratë që këto kontenierë t'u shërbejnë sa më mirë edhe bizneseve, të cilët komuna i konsideron klientë të rëndësishëm të saj.

1 HEQJA E MBETURINAVE NGA PIKAT E GRUMBULLIMIT				
1.1	MATERIALE	COPE	QMIMI/NJESI	TOTALI
1.1.1	GËLQERE PËR DIZINFEKTIM (0.7KG/PIKË GRUMBULLIMI)	8,299	10	82,990
1.1.2	VESHMBATHJE	2	4,800	9,600
1.1.3	MIRËMBAJTJE (8 +5) PIKAT AKTUALE	13	500	6,500
1.1.4	BLERJE KONTENIERË METALIKË	100	25,000	2,500,000
1.1.5	MIRËMBAJTJE E PIKAVE TË REJA TË GRUMBULLIMIT	76	1,000	76,000
			SHUMA	2,675,090
1.2	FUQIA PUNËTORE	ORË	LEKË/ORË	TOTALI
1.2.1	ORË PUNE (2 x 8 x 156) (SHËRBIMI DO T'U OFROHET TRE HERË NË JAVË)	2,503	148	370,444
1.2.2	SIGURIMET SHOQËRORE (%) (PËR 2 PERSONA)	31.7		117,431
			SHUMA	487,875
A	SHUMA TOTALE I			3,162,965

Llogaritja e kostos vjetore për fuqinë punëtore (2 persona) bazohet në formulën: nr. punëtoresh x pagesë mujore x nr. e ditëve të punës. Ndërkohë që llogaritja e kostos vjetore të sigurimeve shoqërore do të bazohet në koston vjetore të pagës sipas standarteve të përcaktuara në kodin e punës.

Transporti dhe eliminimi i mbetjeve – shkarkimi në landfillin rajonal Bushat

Proçesi nëpër të cilin do të kalojë ky shërbim konsiston në heqjen periodike (3 herë në javë) të mbeturinave dhe transportimin e tyre për në landfillin rajonal që ndodhet në një distancë prej 17.23 km nga qendra e fshatit Guri i Zi. Mjeti i transportit të mbeturinave do të nisë itinerarin e mbledhjes nga qendra e fshatit Guri i Zi, (ashtu siç paraqitet edhe në hartat përkatëse) duke përshkruar rreth 4.7 km e më pas do të kryhet mbledhja në pikat e grumbullimit të shpërndara në fshatin Rragam, në kthim do të mbledhë pikat e shpërndara në fshatin Gajtan më pas ato të shpërndara në Rrenc, Vukatanë, Juban dhe Ganjoll. Në total brenda një dite për të kryer mbledhjen e mbeturinave në të gjitha pikat e shpërndara në të shtatë fshatrat si dhe për t'i transportuar ato deri në landfillin rajonal në Bushat, mjeti do të përshkruajë një distancë prej afërsisht 57 km.

2 TRANSPORTI I MBETJEVE NGA PIKAT E GRUMBULLIMIT				
2.1	MATERIALE	LITRA		
2.1.1	KARBURANT (156 DITË x 34.46 KM + 39.16 KM E BËRA BRENDË)/35 LITRA PËR 100 KM	40,19	110	4,421,010
2.1.2	LUBRIFIKANT (1 LITËR PËR 100 KM)	78	350	27,300
2.1.3	VESHMBATHJE	1	4,800	4,800
			SHUMA	4,453,110
2.2	BLERJA DHE MIRËMBAJTJA E MAKINËS TEKNOLOGJIKE			
2.2.1	BLERJE MAKINE TEKNOLOGJIKE E PËRDORUR	1	3,800,000	3,800,000

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Urbane, Komuna Guri i Zi

2.2.2	MIRËMBAJTJE E MJETIT	0.1		380,000
2.2.3	AMORTIZIMI I MJETIT	0.1		380,000
SHUMA				4,560,000

2.3	FUQIA PUNËTORE (SHOFERI)			
2.3.1	ORË PUNE (1 X 8 X 156)	1,280	148	189,440
2.3.2	SIGURIMET SHOQËRORE	31.7		60,052
SHUMA				249,492

Duke u bazuar edhe në eksperiencat e njësive të tjera vendore të cilat kanë synuar futjen e një makine teknologjike për kryerjen dhe modernizimin e shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve të ngurta, është marrë në konsideratë parashikimi i një fondi prej 3.800.000 lekë për blerjen e një makine teknologjike të përdorur por në kushte të mira pune.

Në organikën e sektorit të pastrimit përveç dy punëtorëve është parashikuar edhe një shofer. Ndërkohë që dy punëtorët e transportit kanë për detyrë të organizojnë heqjen e të gjitha mbeturinave familjare nga pikat e grumbullimit si dhe të kryejnë fshirjen me fshesë dhe dizinfektimin me gëlqere të vend grumbullimit me një rreze prej 3 ml.

Proçesi i transportimit të mbeturinave kryhej më parë me një mjet të hapur tip OM me kapacitet 3 ton, i vitit të prodhimit 1986, i cili nuk është në pronësi të bashkisë. Gjithashtu mbetjet hidhen pranë urës së Kirit në një vend-depozitim të hapur i cili përbën një rrezik të madh në drejtim të shëndetit të banorëve dhe ndotjes së mjedisit. Komuna është e bindur për të mos lejuar më shkarkimin e mbetjeve në këtë vend depozitim në të ardhmen. Mbetjet janë parashikuar të transportohen drejt landfillit rajonal që po ndërtohet në komunën Bushat të Qarkut të Shkodrës. Pas bisedimeve me ekspertët e komunës u vendos të parashikohet një taksë për depozitim të mbetjeve në landfill prej 1.230 lekë/ton, të cilat komuna duhet t'ia paguajë autoritetit menaxhues të landfillit.

3 ELEMENIMI I MBETJEVE				
		TON/VIT	LEKË/TON	
3.1	PAGESA PËR SHKARKIMIN E MBETJEVE NË LANDFILL	2,400	1,230	2,952,000

B	SHUMA TOTALE II			12,214,602
----------	------------------------	--	--	-------------------

Në përfundim të gjithë analizës, e cila ka kaluar nëpër të gjitha hapat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta mund të themi se kosto totale për të futur shërbimin e pastrimit, sipas skemës së propozuar në këtë skenar, për shtatë fshatrat Guri i Zi, Juban, Vukatanë, Rrenc, Rragam, Ganjoll, dhe Gajtan është:

A+B	KOSTO TOTALE E SHËRBIMIT TE PASTRIMIT			15,377,567
------------	--	--	--	-------------------

Në fakt kjo kosto siç e kemi shpjeguar edhe më parë është e përbërë nga kosto operacionale (e cila duhet të mbulohet nga taksat e mbledhura për ofrimin e këtij shërbimi) dhe kosto e investimit e cila do të shpenzohet kryesisht vetëm vitin e parë (si dhe kur të kemi modernizim të shërbimit apo shtrirje me te gjere te tij)

C	KOSTO E INVESTIMEVE			6,300,000
----------	----------------------------	--	--	------------------

	KOSTO E INVESTIMEVE	NR.	LEKË/NJËSI	TOTALI
1	BLERJE KONTAINERË METALIKË (PËR ZBATIM TË SKEMËS + FONDI REZERVË) (76+24)	100	25,000	2,500,000

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Urbane, Komuna Guri i Zi

2	BLERJE MAKINE TEKNOLOGJIKE TË PËRDORUR	1	3,800,000	3,800,000
			SHUMA	6,300,000

Përfundimisht kosto operative e cila është edhe objekt i mbulimit nga taksat e mbledhura nga kategoritë që e përfitojnë këtë shërbim është:

(A+B)- C	KOSTO OPERACIONALE E SHËRBIMIT TE PASTRIMIT	9,077,567
-------------	---	-----------

4.3.2 Skenari i dyte: Pika të hapura grumbullimi, makinë e hapur dhe depozitim në landfillin rajonal Bushat

Ndryshimet e bëra në këtë skenar kryesisht ndikojnë në kostot e investimit kapital në infrastrukturë. Në këtë rast janë marrë në konsideratë ndërtimi i pikave të hapura prej betoni (76 të tilla) si dhe blerja e një makine të hapur për transportin e mbetjeve deri në landfillin rajonal. Llogjika e llogaritjes së kostove është e njëjtë si edhe në skenarin e parë, ndaj për të shmangur përsëritjet po paraqesim shkurtimisht tabelat e kostove për këtë skemë grumbullimi të propozuar sipas këtij skenari.

Mbledhja e mbeturinave nga pikat e grumbullimit

HEQJA E MBETURINAVE NGA PIKAT E HAPURA TE GRUMBULLIMIT				
1				
1.1	MATERIALE	COPË	QMIMI/NJËSI	TOTALI
1.1.1	GËLQERE PËR DIZINFECTIM (0.7 KG/PIKË GRUMBULLIMI)	8,299	10	82,990
1.1.2	VESHMBATHJE	2	4,800	9,600
1.1.3	MIRËMBAJTJE (8 +5) PIKAT AKTUALE	13	500	6,500
1.1.4	NDËRTIM PIKASH TË HAPURA BETONI	76	15,000	1,140,000
			SHUMA	1,239,090
1.2	FUQIA PUNËTORE	ORË	LEKË/ORË	TOTALI
1.2.1	ORË PUNE (2 x 8 x 156) (SHËRBIMI DO TË DFROHET TRE HERË NË JAVË)	2,503	148	370,444
1.2.2	SIGURIMET SHOQËRORE (%) (PËR 2 PERSONA)	31.7		117,431
			SHUMA	487,875
A	SHUMA TOTALE I			1,726,965

Transporti dhe eliminimi i mbetjeve – shkarkimi në landfillin rajonal Bushat

2 TRANSPORTI I MBETJEVE NGA PIKAT E GRUMBULLIMIT				
2.1	MATERIALE	LITRA		
2.1.1	KARBURANT (156 DITË X 34.46 KM + 39.16 KM E BËRA BRENDA)/35 LITRA PËR 100 KM	40,19		
		1	110	4,421,010
2.1.2	LUBRIFIKANT (1 LITËR PËR 100 KM)	78	350	27,300
2.1.3	VESHMBATHJE	1	4,800	4,800
			SHUMA	4,453,110
2.2	BLERJA DHE MIRËMBAJTJA E MAKINËS TEKNOLOGJIKE			
2.2.1	BLERJE MAKINE TË HAPUR	1	1,200,000	1,200,000
2.2.2	MIRËMBAJTJE E MJETIT	0.1		120,000
2.2.3	AMORTIZIMI I MJETIT	0.1		120,000
			SHUMA	1,440,000

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Urbane, Komuna Guri i Zi

2.3	FUQIA PUNËTORE (SHOFERI)			
2.3.1	ORË PUNE (1 X 8 X 156)	1,280	148	189,440
2.3.2	SIGURIMET SHOQËRORE	31.7		60,052
			SHUMA	249,492
3 ELEMENIMI I MBETJEVE				
		TON/VIT	LEKË/TON	
3.1	PAGESA PËR SHKARKIMIN E MBETJEVE NË LANDFILL	2,341	1,230	2,879,430

Në përfundim të gjithë analizës, e cila ka kaluar nëpër të gjitha hapat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta mund të themi se kosto totale për të futur shërbimin e pastrimit, sipas skemës së propozuar në këtë skenar, për shtatë fshatrat e komunës Guri i Zi është:

A+B	KOSTO TOTALE E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	10,748,997
------------	--	-------------------

Në fakt zeri që ka pësuar uljen më të ndjeshme është kosto e investimeve e cila paraqitet si më poshtë:

C	KOSTO E INVESTIMEVE	2,340,000
----------	----------------------------	------------------

	KOSTO E INVESTIMEVE	NR.	LEKË/NJËSI	TOTALI
1	NDËRTIM PIKASH TË HAPURA BETONI	76	15,000	1,140,000
2	BLERJE MAKINE TË HAPUR	1	1,200,000	1,200,000
			SHUMA	2,340,000

Përfundimisht kosto operative e cila është edhe objekt i mbulimit nga taksat e mbledhura nga kategoritë që e përfitojnë këtë shërbim sipas këtij skenari të propozuar është:

(A+B)-C	KOSTO OPERACIONALE E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	8,408,997
----------------	--	------------------

4.3.3 Skenari i tretë: Pika të hapura grumbullimi dhe makinë e hapur shkarkimi i mbetjeve në vend-depozitim aktual

E kemi quajtur këtë skenarin më pak të dëshirueshëm parë nën këndvështrimin mjedisor pasi pas diskutimeve me grupin e punës së ngritur pra në komunën Guri i Zi (në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të këshillit vendor të komunës) ky skenar është parë si më i mundshmi për t'u zbatuar. Arsyeja kryesore pse ky skenar pëlqehet më shumë nga komuna lidhet pikërisht me faturrën e ulët financiare që komuna duhet të paguaje sot. Megjithatë pa më të voglin dyshim ky skenar në të ardhmen do të mbarte me vete një faturë financiare akoma edhe më të madhe se dy skenarët e mësipërm që do të shkaktohet si pasojë e shkatërrimit të mëtejshëm të mjedisit si dhe potencialit për përhapjen e sëmundjeve të shumta higjieno-shëndetësore.

Megjithatë sipas diskutimeve në grupin e punës ndërmjet të tjerave u theksua se shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane është një shërbim i shtrenjtë dhe komunës iu sugjerua që ky shërbim të gjente fillimisht zbatim në fshatra pilot si dhe ajo që është më e rëndësishme të shoqërohet me fushata ndërgjegjësimit që komuniteti vendas të fitojë shprehitë e nevojshme dhe ndryshojë sjelljen e tij duke e bërë miqësore ndaj mjedisit ku jeton, pra komuniteti të ndërgjegjësohet fillimisht jo vetëm për ofrimin e këtij shërbimi por edhe për hedhjen e mbeturinave në pikat e caktuara dhe më pas të mendohet për modernizimin e sistemit (futjen e makines teknologjike dhe kazanëve vetëshkarkues).

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Urbane, Komuna Guri i Zi

Gjithashtu vlen për t'u theksuar fakti se aktualisht landfilli rajonal në komunën Bushat të Qarkut së Shkodrës është duke u ndërtuar dhe akoma nuk ka nisur funksionimin e tij si i tillë. Pra aktualisht nuk ka asnjë dyshim që mbetjet do të depozitohen sërish në vend-depozitim e caktuar nga komuna. Gjithashtu nuk është akoma e qartë se sa do të jetë pagesa për ton mbetjesh të depozituara në landfill në të ardhmen (për këtë arsye specifike në llogaritjet e mëposhtme kjo tarifë është eliminuar). Gjithsesi është e rëndësishme që komuna të ndërjegjësohet se në vendosjen e tarifave për përfituesit e shërbimeve kjo taksë (lekë/ton mbetjesh të depozituara) është shumë e rëndësishme dhe ka një influencë të madhe në llogaritjen e kostos së plotë të shërbimit të pastrimit, dhe për rrjedhojë edhe në përcaktimin e tarifave. Sipas këtij skenari të propozuar kemi:

Mbledhja e mbeturinave nga pikat e grumbullimit

HEQJA E MBETURINAVE NGA PIKAT E HAPURA TE GRUMBULLIMIT				
1				
1.1	MATERIALE	COPË	ÇMIMI/NJËSI	TOTALI
1.1.1	GËLQERE PËR DIZINFEKTIM (0.7 KG/PIKË GRUMBULLIMI)	8,299	10	82,990
1.1.2	VESHMBATHJE	2	4,800	9,600
1.1.3	MIRËMBAJTJE (8 +5) PIKAT AKTUALE	13	500	6,500
1.1.4	NDËRTIM PIKASH TË HAPURA BETONI	76	15,000	1,140,000
SHUMA				1,239,090
1.2	FUQIA PUNËTORE	ORË	LEKË/ORË	TOTALI
1.2.1	ORË PUNE (2 x 8 x 156) (SHËRBIMI DO TË OFROHET TRE HERË NË JAVË)	2,503	148	370,444
1.2.2	SIGURIMET SHOQËRORE (%) (PËR 2 PERSONA)	31.7		117,431
SHUMA				487,875
A	SHUMA TOTALE I			1,726,965

Transporti dhe eliminimi i mbetjeve – shkarkimi në landfillin rajonal Bushat

2 TRANSPORTI I MBETJEVE NGA PIKAT E GRUMBULLIMIT				
2.1				
MATERIALE	LITRA			
KARBURANT (156 DITË x 34.46 KM + 39.16 KM E BËRA BRENDA)/35 LITRA PËR 100 KM	40,19			
2.1.1	1	110		4,421,010
2.1.2	LUBRIFIKANT (1 LITËR PËR 100 KM)	78	350	27,300
2.1.3	VESHMBATHJE	1	4,800	4,800
SHUMA				4,453,110
2.2				
BLERJA DHE MIRËMBAJTJA E MAKINËS TEKNOLOGJIKE				
2.2.1	BLERJE MAKINE TË HAPUR	1	1,200,000	1,200,000
2.2.2	MIRËMBAJTJE E MJETIT	0.1		120,000
2.2.3	AMORTIZIMI I MJETIT	0.1		120,000
SHUMA				1,440,000
2.3				
FUQIA PUNËTORE (SHOFERI)				
2.3.1	ORË PUNE (1 x 8 x 156)	1,280	148	189,440
2.3.2	SIGURIMET SHOQËRORE	31.7		60,052
SHUMA				249,492
B	SHUMA TOTALE II			6,142,602

Në përfundim të gjithë analizës, e cila ka kaluar nëpër të gjitha hapat e menaxhimit të mbetjeve të ngurta mund të themi se kosto totale për të futur shërbimin e pastrimit, sipas skemës së propozuar në këtë skenar, për shtatë fshatrat e komunës Guri i Zi është:

A+B	KOSTO TOTALE E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	7,869,567
------------	--	------------------

Në fakt zëri që ka pësuar uljen më të ndjeshme është sërishmi kosto e investimeve (në këtë skemë kostoja e investimeve është më e lartë se skenari numër 2, por më e ulët e cila paraqitet si më poshtë:

	KOSTO E INVESTIMEVE	NR.	LEKË/NJËSI	TOTALI
1	NDËRTIM PIKASH TË HAPURA BETONI	76	15,000	1,140,000
2	BLERJE MAKINE TË HAPUR	1	1,200,000	1,200,000
SHUMA				2,340,000

C	KOSTO E INVESTIMEVE	2,340,000
----------	----------------------------	------------------

Përfundimisht kosto operative e cila është edhe objekt i mbulimit nga taksat e mbledhura nga kategoritë që e përfitojnë këtë shërbim sipas këtij skenari është:

(A+B)-C	KOSTO OPERACIONALE E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	5,529,567
----------------	--	------------------

4.4 Përcaktimi i tarifës së shërbimit të pastrimit

Objektivi i Komunës Guri i Zi është mbulimi i koston operative me të ardhurat e gjeneruara nga mbledhja e taksës së pastrimit nga të treja kategoritë që e përfitojnë këtë shërbim; (i) Banorët, (ii) Bizneset dhe (iii) Institucionet. Komuna është e ndërgjegjshme se arritja e këtij objektivi që vitin e parë të ofrimit të këtij shërbimi do të ishte e parakoshme, ndaj ka parashikuar që ky objektivi të plotësohet deri në vitin 2013. Sipas peshës specifike sipas të gjitha kategorive ndarja e kostove është përcaktuar si më poshtë:

ALOKIMI I KOSTOS NË PËRQINDJE SIPAS KATEGORIVE TË PËRDORUESVE	2009	2010	2011	2012	2013
FAMILJET	70%	70%	70%	70%	70%
BIZNESET	28%	28%	28%	28%	28%
INSTITUCIONET	2%	2%	2%	2%	2%
PËRQINDJA TOTALE	100%	100%	100%	100%	100%

4.4.1 Llogaritja e tarifës sipas skenarit të parë

Duke marrë në konsideratë që kosto operative e llogaritur sipas skenarit të parë është 9,077,567 lekë si dhe objektivin për të mbuluar këtë kosto vitin e parë (2009) 85% e duke vazhduar deri në 2013 (100%) tabela e mëposhtme jep shpërndarjen e mbulimit në vite.

Përqindja e mbulimit të koston sipas viteve	2009	2010	2011	2012	2013
	80%	85%	90%	95%	100%
Shuma e mbulimit të koston në vite	7,262,054	7,715,932	8,169,811	8,623,689	9,077,567


Parashikimi i të ardhurave të mbledhura nga çdo kategori që e përfiton shërbimin paraqitet në tabelën e mëposhtme:


Pesha specifike e kostos që mbulohet nga familjet	70%	70%	70%	70%	70%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga familjet	5,083,438	5,401,153	5,718,867	6,036,582	6,354,297
Pesha specifike e kostos që mbulohet nga bizneset	28%	28%	28%	28%	28%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga bizneset	2,033,375	2,160,461	2,287,547	2,414,633	2,541,719
Pesha specifike e kostos që mbulohet nga institucionet	2%	2%	2%	2%	2%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga institucionet	145,241	154,319	163,396	172,474	181,551

Përfundimisht në tabelën e mëposhtme jepet niveli i tarifave për vitet 2009 – 2013 për të treja kategoritë e përfituesve të shërbimeve. Nëse tarifat do të ngrihen në mënyrë progresive çdo vit të shoqëruara edhe me rritjen e cilësisë së shërbimit komuna do të mund të realizojë objektivin e saj, pra mbulimin e kostove operative nga tarifa e shërbimit.

Niveli i Tarifave që mbulon koston e shërbimit deri në vitin 2013	2009	2010	2011	2012	2013
Familjet që kanë mundësi për të paguar 2437	2,086	2,216	2,347	2,477	2,607
Nr. i bizneseve 80	25,417	27,006	28,594	30,183	31,771
Nr. i institucioneve 21	6,916	7,349	7,781	8,213	8,645

Grafikët e mëposhtëm përmbledhin të gjitha tabelat e mësipërme duke na dhënë një pamje me të qarte persha i perket realizimit të të ardhurave nga mbledhja e takses së pastrimit si dhe raportin e nivelit të tarifave brenda tre kategorive që e përfitojnë shërbimin.





4.4.2 Llogaritja e tarifës sipas skenarit të dytë

Duke marrë në konsideratë që kosto operative e llogaritur sipas skenarit të dytë është 8,408,997lekë si dhe objektivin për të mbuluar këtë kosto vitin e parë (2009) 85% e duke vazhduar deri në 2013 (100%) tabela e mëposhtme jep shpërndarjen e mbulimit në vite.

Përqindja e mbulimit të koston sipas viteve	2009	2010	2011	2012	2013
		80%	85%	90%	95%
Shuma e mbulimit të koston në vite	6,727,198	7,147,648	7,568,098	7,988,547	8,408,997



Parashikimi i të ardhurave të mbledhura nga çdo kategori që e përfiton shërbimin sipas skenarit të dytë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Pesha specifike e koston që mbulohet nga familjet	70%	70%	70%	70%	70%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga familjet	4,709,038	5,003,353	5,297,668	5,591,983	5,886,298
Pesha specifike e koston që mbulohet nga bizneset	28%	28%	28%	28%	28%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga bizneset	1,883,615	2,001,341	2,119,067	2,236,793	2,354,519
Pesha specifike e koston që mbulohet nga institucionet	2%	2%	2%	2%	2%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga institucionet	134,544	142,953	151,362	159,771	168,180

Përfundimisht në tabelën e mëposhtme jepet niveli i tarifave për vitet 2009 – 2013 për të treja kategoritë e përfituesve të shërbimit të pastrimit. Nëse tarifatat do të ngrihen në mënyrë progresive çdo vit të shoqëruara edhe me rritjen e cilësisë së shërbimit komuna do të mund të realizojë objektivin e saj, pra mbulimin e koston operative nga tarifa e shërbimit sipas skenarit të dytë.

Niveli i Tarifave që mbulon koston e shërbimit deri në vitin 2013	2009	2010	2011	2012	2013
Familjet që kanë mundësi për të paguar 2437	1,932	2,053	2,174	2,295	2,415
Nr. bizneseve 80	23,545	25,017	26,488	27,960	29,431
Nr. i institucioneve 21	6,407	6,807	7,208	7,608	8,009

Grafikët e mëposhtëm përmbledhin të gjitha tabelat e mësipërme duke na dhënë një pamje më të qartë përse i përket realizimit të të ardhurave nga mbledhja e taksës së pastrimit si dhe raportin e nivelit të tarifave brenda tre kategorive që e përfitojnë shërbimin sipas skenarit të dytë.



4.4.3 Llogaritja e tarifës sipas skenarit të tretë

Duke marrë në konsideratë që kosto operative e llogaritur sipas skenarit të trete është 5,529,567lekë si dhe objektivin për ta mbuluar këtë kosto vitin e parë (2009) 80% e duke vazhduar deri në 2013 (100%) tabela e mëposhtme jep shpërndarjen e mbulimit në vite.

Përqindja e mbulimit të koston sipas viteve	2009	2010	2011	2012	2013
	80%	85%	90%	95%	100%
Shuma e mbulimit të koston në vite	4,423,654	4,700,132	4,976,611	5,253,089	5,529,567


Parashikimi i të ardhurave të mbledhura nga çdo kategori që e përfiton shërbimin sipas skenarit të tretë paraqitet në tabelën e mëposhtme::


Pesha specifike e kostos që mbulohet nga familjet	70%	70%	70%	70%	70%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga familjet	3,096,558	3,290,093	3,483,627	3,677,162	3,870,697
Pesha specifike e kostos që mbulohet nga bizneset	28%	28%	28%	28%	28%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga bizneset	1,238,623	1,316,037	1,393,451	1,470,865	1,548,279
Pesha specifike e kostos që mbulohet nga institucionet	2%	2%	2%	2%	2%
Parashikimi i të ardhurave të grumbulluara nga institucionet	88,473	94,003	99,532	105,062	110,591

Përfundimisht në tabelën e mëposhtme jepet niveli i tarifave për vitet 2009 – 2013 për të treja kategoritë e përfituesve të shërbimit të pastrimit. Nëse tarifat do të ngrihen në mënyrë progresive çdo vit të shoqëruara edhe me rritjen e cilësisë së shërbimit komuna do të mund të realizojë objektivin e saj, pra mbulimin e kostove operative nga tarifa e shërbimit sipas skenarit të tretë.

Niveli i Tarifave qe mbulon koston e sherbimit deri ne vitin 2013	2009	2010	2011	2012	2013
Familjet qe kane mundesi per te paguar 2437	1,271	1,350	1,429	1,509	1,588
Nr I bizneseve 80	15,483	16,450	17,418	18,386	19,353
Nr I institucioneve 21	4,213	4,476	4,740	5,003	5,266

Grafikët e mëposhtëm përmbledhin të gjitha tabelat e mësipërme duke na dhënë një pamje më të qartë përsa i përket realizimit të të ardhurave nga mbledhja e taksës së pastrimit si dhe raportin e nivelit të tarifave brenda tre kategorive që e përfitojnë shërbimin sipas skenarit të tretë.





4.5 Struktura Organizative e Propozuar për zbatimin e PMMU

Reforma në lidhje me përmirësimin e shërbimeve publike në tërësi dhe atë të shërbimit të pastrimit në veçanti është një prej objektivave të komunës së Gurit të Zi. Në kuadër të kompetencave të pushtetit vendor si dhe analizës bazuar në vlerësimet e situatës ekzistuese dhe kapaciteteve të komunës si financiare, logjistike dhe burimeve njerëzore, është menduar që shërbimi i pastrimit të jetë pjesë e strukturës menaxhuese të komunës, pra nën varësinë dhe administrimin e saj, duke u bazuar në rekomandimet e planit strategjik për arritjen e një qeverisje të mirë. Plani Strategjik i Zhvillimit për komunën Guri i Zi (hartuar në vitin 2008) përcakton si më poshtë vijon (fq 54-55):

3.4.4 Objektiv D – Qeverisja e Mirë

Për sa i përket arritjes së këtij objektiv të rëndësishëm, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

përcakton:

- Rritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative të stafit të Komunës Gur i Zi.
- Përmirësimi i nivelit të transparencës në vendimmarrjen vendore në Komunë.
- Përmirësimi i pjesëmarrjes së komunitetit vendor në vendimmarrjen në Komunë.

D.1 - Rritja e kapaciteteve të stafit në Komunën Guri i Zi

Rezultate të pritshme Veprime konkrete të propozuara

a. Vlerësimi i skemës organizative të Komunës dhe identifikimi i nevojave për përmirësim.

1. Analiza institucionale e skemës organizative të Komunës Guri i Zi, duke u fokusuar në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve si dhe të funksionimit normal të infrastrukturave publike.

2. Konsolidimi i Zyrës së Koordinimit Zhvillimit në Komunën Guri i Zi.

b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të administratës së Komunës.

1. Organizimi i trajnimeve periodike për rritjen e kapaciteteve të stafit të Komunës Guri i Zi në fushat e menaxhimit të territorit si dhe të shërbimeve publike.

2. Organizimi i trajnimeve për menaxhimin financiar në administratën e Komunës.

3. Vlerësimi i përcaktimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit për Komunën si dhe i përgjegjësi që ajo identifikon për administratën.

Aktualisht sektori i shërbimeve përfaqësohet me 1 përgjegjës por nuk ka një strukturë organizative, e cila të jetë pjese e organogramës së komunës me detyra dhe kompetenca të qarta ushtrimi detyre.

Duke u nisur dhe nga skenarët e sipërpërmendur paraqitet e nevojshme ngritja e një skuadre për shërbimin e pastrimit e cila do të fillojë menjëherë punën për zbatimin e skemës së propozuar për menaxhimin e mbeturinave dhe do të jetë në vijim përgjegjëse për komponentët e këtij shërbimi. Kjo skuadër do të përfshijë punëtorët e ngarkim-shkarkimit të mbeturinave gjatë proçsit të heqjes së tyre nga pikat e grumbullimit dhe transportimit të tyre për në vendin e depozitimit si edhe gjatë heqjes e mbeturinave në rrugët dhe sheshet kryesore, drejtuesin e makinës për heqjen e mbeturinave.

Mekanizimi i shërbimit të pastrimit, duke u shoqëruar me aplikimin i skemës për futjen e makinës teknologjike dhe kontenierëve metalikë krijon mundësi për uljen e kostove të shërbimit dhe rritjen e efijencës së punës. Pra gjatë ngritjes së strukturës organizative dhe detajimit të përshkrimit të punës është e nevojshme të llogariten kostot operative dhe në varësi të skemës së propozuar dhe miratuar për zbatim.

Në vitet në vijim, duke u bazuar dhe në raportet e proçsit të monitorim-vlerësimit, komuna do të rishikojë riorganizimin e punës dhe strukturës organizative në funksion të rritjes dhe përmirësimit të efijencës së shërbimit për qytetarët nga njëra anë dhe nga ana tjetër marrjes në konsideratë të kostove përkatëse të këtij shërbimi.

4.6 Zbatimi i Skemës së Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në komunën Guri i Zi

Komuna e Gurit të Zi është e përbërë nga 10 fshatra në total. Zbatimi i skemës propozohet të fillohet me ofrimin e shërbimit në fshatrat më të mëdhenj të kësaj komune, përkatësisht në fshatin Guri i Zi dhe Juban. Më pas skema propozohet të vijojë në vitin 2010-2011 me të gjithë fshatrat më popullsi mbi 1000 banorë, duke bazuar në shpërndarjen e popullsisë sipas fshatrave në komunë, fshatrat që do të përfshihen në plan janë:

1. Rrenc
2. Vukatanë

Metodologjia për zbatimin dhe shtrirjen e skemës do të jetë e njëjtë me atë të propozuar për zonat pilot dhe do të zbatohet në mënyrë të përpiktë elementët teknikë dhe financiarë për ofrimin e një shërbimi cilësor të pastrimit duke marrë në konsideratë se njëkohësisht me zbatimin e skemës për këto fshatra do të fillojë dhe aplikimi i tarifës së pastrimit për kategoritë përfituese.

Duke qënë se plani për menaxhimin e mbetjeve urbane është një instrument pune në duart e komunës, ai është fleksibël dhe i hapur për ndryshimet e nevojshme duke u bazuar në përfundimet e proçsit të monitorimit dhe vlerësimit për çdo vit zbatimi të skemës. Treguesit përkatës të këtij proçesi do të

përcaktojnë dhe rekomandimet e nevojshme për ndërhyrjet e mëtejshme të cilat do të përmirësojnë, konsolidojnë dhe shtrijnë këtë skemë në të gjithë territorin e komunës.

Në këtë kuadër fshatrat e renditur për aplikimin e skemës së menaxhimit janë:

1. Rragam
2. Gajoll
3. Gajtan

Përsa i takon fshatrave Shpor-Mazrek dhe Sheldi, duke marrë në konsideratë mungesën e organizimit të tyre territorial, shpërndarjen e madhe të zonave të banimit, numrin e ulët të popullsisë, vendndodhja në zonë të largët malorë dhe mungesa e infrastrukturës rrugorë (gjendja jo e mirë e kushteve të rrugës dhe mungesa e parametrave teknikë) nuk do të jenë pjesë e shtrirjes së propozuar së skemës të paktën për një periudhë 5- vjeçare.

Hapat e propozuar për shtrirjen e skemës në mënyrë të përshkallezuar do të përfshijnë:

- ✓ Hartimin dhe përditësimin e një baze të dhënash për fshatrat (ku përfshihen të dhënat e popullsisë, niveli i të ardhurave, kategoritë e njësive përfituese, të dhënat e veprimtarisë ekonomike, të dhënat e matjeve teknike për rrugët dhe sheshet)
- ✓ Identifikimin e infrastrukturave përkatëse dhe hapësirave të nevojshme publike që mundësojnë zbatimin e skemës
- ✓ Identifikimin e investimeve të nevojshme për të mundësuar zbatimin e skemës
- ✓ Llogaritjen e kostos së shërbimit
- ✓ Llogaritjen e tarifës së shërbimit bazuar në koston e shërbimit dhe numrin e njësive përfituese
- ✓ Përgatitjen e hartave dhe identifikimin e pikave të grumbullimit
- ✓ Identifikimin e zonave të nxehta mjedisore
- ✓ Përcaktimi i vlerës së tarifës së shërbimit

4.7 Nje veshtrimi pergjithshem mbi mbetjet e veçanta dhe trajtimin e tyre

Qëllimi i paraqitjes në këtë dokument të këtij informacioni lidhet me rishikimin e situatës së mbetjeve në komunë të kategorizuara si mbeturina të veçanta, të cilat kanë një ndikim të caktuar mbi mjedisin në tërësi për të ardhmen në këtë komunë, por mbi të gjitha duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit dhe rishikimit të skemës së menaxhimit të mbeturinave urbane nga komuna në vijim.

Arsyeja se përse këto kategori mbeturinash konsiderohen të kenë një ndikim gjatë zbatimit të skemës së propozuar për menaxhimin e mbeturinave urbane në Komunën Guri i Zi lidhet me faktin se ashtu si në nivel qendror edhe në nivel vendor mungon shërbimi dhe infrastruktura për të realizuar ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave që paraqiten në skemë (mbeturinat urbane). Kjo situatë ka krijuar një grumbullim të llojeve të ndryshme të mbeturinave të cilat nuk mund të grumbullohen, transportohen dhe venddepozitohen në të njëjtën mënyrë por kërkojnë një standart trajtimi të veçantë, në mënyrë që të ruhen dhe mbrohen parametrat e shëndetit, higjenes dhe në tërësi mjedisit për çdo komponent të tij.

Mbeturinat bujqësore:

Të gjitha ato lloje mbeturinash të cilat prodhohen si rezultat i aktivitetit bujqësor apo blegtoral (fermat e ndryshme apo njësi të tjera që prodhojnë), duke përjashtuar mbeturinat e zakonshme të shtëpisë apo

mbeturinat me rrezik të moderuar (si psh pesticidet apo lëndë kimike të tjera) të cilat do t'i përmendim më poshtë.

Aktualisht Komuna Guri i Zi është e përbërë nga 10 fshatra dhe si e tillë riaktivizimi dhe rigjallërimi i fermave bujqësore dhe blegtorale mbetet një nga prioritetet për zhvillim që ka filluar të zhvillohet edhe pse në mënyrë të ngadaltë këto vitet e fundit. Duke qënë se komuna nuk ka të dhëna për sasinë dhe burimin e gjenerimit të këtyre lloj mbeturinave, mbetet të jetë një rekomandim për matje në të ardhmen dhe marrjen parasysh gjatë rishikimit të PMMU në vitet në vijim.

Gjithsesi një plan paraprak aksioni mund të ndërrmerret nga komuna në bashkëpunim me komunitetin për të realizuar disa masa të cilat nuk kërkojnë përdorimin e teknologjisë së lartë por ndihmojnë në reduktimin e ndotjes përgjatë kanaleve të mbledhjes së ujërave të bardha, të cilat aktualisht janë një problem i mjedisit në këtë komunë dhe burim i pafund potencialesh rreziku për shëndetin dhe higjenën publike.

Mbeturinat e kafshëve:

Këto lloje mbetjesh përfshijnë ato pjesë mbeturinash të tilla si kufomat e kafshëve në rrugë nga rastet e aksidenteve nga makinat apo mjetet e tjera të transportit dhe të punës, mbeturinat e kafshëve si rezultat i klinikave veterinare apo therrtove të caktuara që operojnë në një zonë. Por në të njëjtën kohë edhe mbetjet e kafshëve në ferma pasi ato therrren apo nuk përdoren më (plakja dhe ngordhja e kafshëve të punës etj...)

Në komunën Guri i Zi trajtimi i këtyre mbetjeve ende nuk duket të jetë i evidentuar si problematik pasi është ende herët për të marrë masa specifike në këtë drejtim, duke qënë se komuna është në hapat e parë të futjes së shërbimit të mbledhjes, transportit dhe venddepozitimit të mbeturinave urbane.

Megjithatë konsideruar mundësitë për paraqitjen e këtyre llojeve të mbeturinave me zhvillimin e pritshëm sidomos në ngritjen e therrtove të ndryshme paraqitet e nevojshme ndërtimi i bashkëpunimit me fermerët vendas dhe urave të komunikimit me ta, të cilat do t'i shërbejnë në të ardhmen skemës për menaxhimin e mbeturinave s

Mbetjet bio-mjekësore

Komuna e Gurit të Zi ka në total një numër prej 10 qendrash shëndetësore me një shpërndarje prej 1 qendër shëndetësore për çdo fshat duke mbuluar në këtë mënyrë shërbimin shëndetësor për banorët e komunës. Shërbimet aktuale shëndetësore mbulojnë shërbime ambulatorë, mjekime dhe nderhyrje të lehta, vaksinime, asistohet gruaja shtatzane pasi të gjitha infermieret janë edhe mami, por nuk ofrohet shërbimi i lindjes.

Por në këndvështrimin mjedisor të trajtimit të mbeturinave që gjenerohen nga këto qendra, problemi tërheq vëmendjen e komunës pasi aktualisht nuk ekziston trajtimi i veçantë i këtyre mbetjeve.

Gjatë vizitave në qendrat shëndetësore të fshatit Guri i Zi dhe Juban si edhe sipas të dhënave të mbledhura nga takimet e realizuara me drejtoreshën e qendrave shëndetësore mbetjet kryesore që gjenerohen grupohen në 3 kategori lënëdash si më poshtë shpjeguar:

- Mbetje qelqi – të tilla si ampula të llojeve të ndryshme dhe flakonë të përmasave të ndryshme

- Mbetje plastike –të tilla si shiringa dhe doreza higjenike
- Mbetje letre –të tilla si ambalazhe të formave dhe madhësive të ndryshme si kuti kartoni, paketime ilaçesh kartoni dhe letre, letra të ndryshme
- Mbetje të rrezikshme –të tilla si fasho të ndotura nga gjaku, plazma apo mikroorganizma si mikrobe dhe baktere të ndryshme

Trajtimi i këtyre mbeturinave facilitohet si proces nga Drejtoria e Shëndetit Publik Rajonal e cila iu ofron qëndrave shëndetësore furnizimin me “safe deposit bag”, një kuti kartoni për depozitimin me siguri të lartë të tyre. Shpërndarja e këtyre kutive realizohet në mënyrë periodike mujore dhe sasia e furnizimit nuk e kalon 1- 2 kuti në muaj. Në këto qëndra nuk ekziston asnjë sistem për matjen e sasisë së prodhimit të mbeturinave dhe analiza mbi domosdoshmërinë e numrit më të lartë të këtyre kontenierëve bazohet në gjykimet dhe vlerësimët empirike të punonjësve lidhur me sasinë e shërbimeve të ofruara dhe mjeteve të përdorura përkatëse.

Po kështu mungesa e matjes krijon vështirësi në adresimin e trajtimit të duhur të tyre, pasi mungesa e shifrave nuk ndihmon për një analizë të mirëfilltë të kostove për trajtim në të ardhmen sipas parametrave mjedisore të përcaktuar me ligj apo për rehabilitimin e situatës ekzistuese.

Sipas punonjësve të këtyre qëndrave trajtimi i këtyre mbetjeve është deri diku në një nivel “primitiv” duke përdorur metodën e djegies pas grumbullimit dhe depozitimit të tyre në një gropë të hapur pak metra larg qëndrës shëndetësore. Aktualisht frekuenca e procesit të djegies së mbeturinave kryhet një here në 2 ose 3 javë nga punonjëset e këtij institucioni.

Ndërkohë vendi në të cilin është hapur gropa për djegien e tyre nuk ka asnjë mekanizëm izolimi dhe mbetjet nuk diferencohen përpara se të kryhet procesi i asgjësimit të tyre, dhe në të njëjtën kohë nga vëzhgimet në zonë ai ndodhet shumë afër një prej kanaleve të kullimit të ujërve të bardha por rreziku mbetet i lartë lidhur më vendndodhjen e gropës brenda territorit të shkollës 9-vjeçare.

Si rrjedhojë shkalla e rrezikshmërisë për shpërhapjen e ndotjes dhe infeksioneve mbetet e lartë, ndonëse sasia e mbeturinave që digjen nuk konsiderohet e lartë nga punonjësit e komunës dhe qëndrave shëndetësore. Banorët e moshave më të reja dhe në mënyrë të veçantë fëmijët e përdorin territorin e oborrit të shkollës edhe pas përfundimit të orarit shkollor ku ata janë jashtë kontrollit apo vëmendjes së mësuesve apo prindërve për t’u këshilluar, orientuar apo ndaluar për të prekur dhe përdorur si mjete loje qoftë dhe rastësisht objekte që janë të ndotura nga këto lloje mbetjesh (edhe pas procesit të djegies).

Krahas shërbimit mjekësor të ofruar në qëndra shëndetësore, një pjesë e mirë e tij ofrohet si shërbim kujdesi shëndetësor në shtëpi, të cilat mbulojnë shërbime infermierie në shtëpi si mjekim plagësh të ndryshme etj. Gjatë intervistës së kryer, drejtoresha e qëndrës shëndetësore në fshatin Juban dhe atë të Gurit të Zi pohoi se në këto raste trajtimi i mbetjeve mjekësore bëhet vërtet problematik, për arsye se mbeturinat e mjeteve të përdorura apo medikamenteve të ndryshme nuk izoloohen apo kthehen mbrapsht në qëndrën shëndetësore por i bashkohen mbeturinave të tjera të ngurta urbane dhe atyre që prodhohen nga konsumi i familjes duke u derdhur së bashku në pikat aktuale të grumbullimit përgjatë kanaleve të kullimit apo brenda tyre. Këto pika grumbullimi përbëjnë pikërisht ato që quhen dhe zona të nxehta mjedisore të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe rehabilitim.

Duke qënë se trajtimi i kategorisë së mbetjeve të veçanta në përgjithësi dhe në veçanti i mbetjeve mjekësore përbën një sfidë në nivelet e qeverisjes si qëndrore dhe vendore, edhe komuna e Gurit të Zi

ka kapacitete të limituara financiare dhe logjistike për të përballuar këtë shërbim të trajtimit të mbeturinave.

Nisur nga situata e sipërpërmendur grupi i punës pas takimeve të realizuar konkludoi se PMMU do të parashikojë ngritjen e një grupi për vlerësimin e situatës në pikëpamjen e matjes së mbeturinave që gjenerohen nga qendrat shëndetësore si hapi i parë drejt gjetjes së instrumentave për trajtim. Gjithashtu do të parashikohet në vijim mundësia që komuna të zhvillojë bashkëpunimin me njësitë e tjera vendore fqinje për grumbullimin e kësaj kategorie mbetjeje dhe transportimin e tyre në incineratorin rajonal, i cili është i vendosur në Shkodër.

Në të njëjtën kohë programi për ndërgjegjësimin e komunitetit do të përfshijë informimin e popullatës mbi rrezikshmërinë e kësaj kategorie mbetjeje dhe materiale takime informimi mund të përgatiten dhe organizohen si në qendrën shëndetësore por dhe në qendrën komunitare. Po ashtu dhe rritja e ndërgjegjësimit do të fokusohet edhe në kujdesin për të izoluar qoftë dhe në rrugë minimale këto mbeturina nga mbeturinat e tjera të konsumit familjar apo urbane.

Mbeturinat ndërtimore

Kjo kategori mbeturinash përfshin të gjitha ato mbetje të cilat gjenerohen si rezultat i veprimtarisë ndërtimore apo prishjeve të objekteve të ndryshme në një zonë të caktuar në territorin e komunës Guri i Zi.

Edhe pse zhvillimi i ndërtimit në komunën Guri i Zi nuk është në hapa të përparuar dhe si rrjedhojë nuk paraqitet ndonjë situatë e cila të gjenerojë probleme të ndotjes së mjedisit me mbetje inerte, gjithsesi mungesa e kontrollit për ndjekjen e procedurave të caktuara lidhur me grumbullimin, transportin dhe venddepozitimin e këtyre mbetjeve edhe pse në sasi të vogla ka patur ndikimin e saj në përkeqësimin e kushteve mjedisore.

Këto lloje mbetjesh gjenden rëndom dhe mund të vëzhgohen edhe me sy të lirë përgjatë pikave ekzistuese të grumbullimit, edhe për faktin se ato zënë një vëllim më të madh krahasuar me mbeturinat e tjera të ngurta urbane me të cilat ato përzihen, në këtë mënyrë ato rrisin artificialisht vëllimin e mbetjeve, gjendje kjo e cila vështirëson shumë transportin dhe venddepozitimin e tyre ndonëse aktualisht përgjatë vendndodhjes së venddepozitimit ekzisues është një zonë e veçuar ku ato depozitohen.

Duke qënë se plani për menaxhimin e mbeturinave të ngurta urbane merr në konsideratë depozitimin e mbetjeve në venddepozitimin e ri të Bushatit (landfill) këto mbeturina inerte duhet të ndahen dhe depozitohen veçmas gjatë zbatimit të skemës së re së propozuar. Për të realizuar këtë ndërhyrje mund të përdoret një makinë e hapur dhe ngarkimi i mbeturinave me anë të lopatave në të.

4.8 Plani i monitorimit dhe vlerësimit të skemës së propozuar

Proçesi i monitorimit të skemës së propozuar është një element mjaft i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e zbatimit me efikasitet të skemës së propozuar.

Monitorimi do të realizohet si nga grupi i punës së komunës ashtu dhe nga grupi i punës së qytetarëve. Të dy këto struktura do të sigurojnë informacionin e saktë në lidhje me ecurinë e zbatimit të skemës në të gjithë elementet e saj nëpërmjet:

- Organizimi i vizitave në terren gjatë orareve të punës sipas grafikut javor përgjatë gjithë vitit
- Organizimi i takimeve konsultative të hapura me grupet përfaqësuese qytetare

Monitorimi i zbatimit të skemës së grumbullimit dhe transportit të mbeturinave nga grupi i qytetarëve do të konsistojë në përfshirjen e opinionit qytetar dhe vlerësimin e tij për:

- mirepërdorimin e fondeve publike për këtë shërbim
- shkallën e kënaqshmërisë qytetare në lidhje me pastërtinë e qytetit
- grumbullimin e pagesës së tarifës së shërbimit të pastrimit nga kategoritë që përfitojnë shërbimin e pastrimit
- kontributet e komunitetit në dobi të zbatimit të skemës

Monitorimi i zbatimit të skemës së grumbullimit dhe transportit të mbeturinave nga skuadra e pastrim gjelbërimit do të konsistojë në këta tregues teknike:

- sasia ditore e tërheqjes së mbeturinave sipas zonave ku shtrihet shërbimi
- frekuenca ditore/javore e tërheqjes së mbeturinave
- efektiviteti i shfrytëzimit të makinës teknologjike sipas infrastrukturës rrugore
- mirëmbajtja e kontenierëve metalikë si dhe perputhja e tyre teknologjike me makinën e mbeturinave
- mbushja e vend depozitimit të mbeturinave

Për të gjithë këta tregues teknike do të monitorohen dhe treguesit financiarë vjetor përkatës si dhe burimet njerëzore të përdorura.

Raporti i monitorimit do të shërbejë për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në përmirësimin e shërbimit të pastrimit dhe uljen e kostove për realizimin e tij.

Buxheti i planifikuar për çdo vit për mbulimin e këtij shërbimi do të konsiderojë treguesit e monitorimit për planifikimin e fondeve dhe shpërndarjen tyre efikase sipas zërave përkatës.

Disa tregues monitorimi propozohen si më poshtë vijon për të matur ecurinë e zbatimit të skemës në vite:

4.8.1 Treguesit e rezultateve për shërbimin e pastrimit të mbeturinave urbane:

- I. Përqindja e totalit të mbeturinave të mblledhura
- II. Numri dhe përqindja e shtëpive që përfitojnë periodikisht shërbimin e mblledhjes së mbeturinave
- III. Frekuenca e mblledhjes së mbeturinave
- IV. Numri dhe përqindja e pargjeve të mbeturinave me një ose më shumë rrezik për shëndetin si rezultat i mosmblledhjes së mbeturinave
- V. Numri i zjarreve për mbeturinat që nuk mblidhen

- VI. Përqindja e familjeve dhe bizneseve që raportojnë mos grumbullimin e mbeturinave
- VII. Përqindja e familjeve dhe bizneseve që raportojnë mbetje nga procesi i grumbullimit të mbeturinave
- VIII. Numri i ankesave të qytetarëve të depozituara lidhur me shërbimin e pastrimit
- IX. Përqindja e zonave që cilësohen të pastra
- X. Përqindja e qytetarëve që raportojnë se nuk janë të informuar rreth standarteve apo tarifave të shërbimit
- XI. Përqindja e kostos së mbuluar nga tarifat e mbledhura për çdo kategori 1) biznese 2) familje 3) institucione

4.9 Plani për ndërgjegjësimin dhe edukimin qytetar

Një ndër komponentët me rëndësi në zbatimin me sukses dhe garantimin e qëndrueshmërisë së planit të menaxhimit të mbeturinave është dhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut për çështje që prekin mbrojtjen e mjedisit. Ky komponent është në përputhje me vete filozofinë me të cilën do të trajtohet ofrimi i shërbimit të pastrimit për vitet në vijim duke nxitur pjesëmarrjen e komunitetit me qellim kontributin aktiv të tij në këtë proces.

Shërbimet publike në tërësi, por sidomos shërbimi i pastrimit paraqesin probleme jo vetëm të nivelit teknik dhe financiar por sidomos në lidhje me përqasjen në komunikimin ndaj komunitetit vendas. Kjo sfidë i takon jo vetëm komunës Guri i Zi, por si e tillë duhet adresuar dhe në nivel rajonal e kombëtar për të ndërtuar dhe forcuar marëdhënien e bashkëpunimit sidomos në lidhje me shkëmbimin e modeleve të ndryshme për t'u zbatuar.

Problemet e hasura në lidhje me ndotjen e mjedisit kushtëzohen në një masë jo të vogël nga shkalla e ndërgjegjësimit të qytetarëve ndaj përgjegjësi që duhen reflektuar për mbarëvajtjen dhe mirë-administrimin e tij.

Në këtë kuadër mund të përmendim probleme të tilla të cilat ndikojnë jo vetëm në cilësinë e shërbimit të propozuar të pastrimit në vijim, por edhe më gjerë për mjedisin në tërësi të komunës. Këto probleme padyshim janë ngritur si shqetësime dhe prurë në vëmendje të cilat janë identifikuar gjatë diskutimeve të përbashkëta me grupin e punës në komunë si psh;

1. Pagesa e rregullt e tarifës: Edhe pse është marrë në konsideratë gjendja dhe niveli ekonomik i jetesës për banorët në komunën e Gurit të Zi, apo mungesa e gjatë në vite pas periudhës së rënies së sistemit komunist e shërbimit të pastrimit të ofruar në të kaluarën, përsëri niveli i të ardhurave nga tarifa e qytetarëve është në nivele shumë të ulta. Në përgjithësi në nivel vendor por dhe kombëtar është trashëguar një perceptim mbi shërbimet që ofrohen nga komuna si të drejta që qytetari zotëron dhe që duhen ofruar nga qeverisja përkatëse vendore apo zgjidhur nga “shteti” në një konceptim shumë njëpalësh për sistemin aktual në të cilin kërkohet një bashkëpunim mes strukturave qeverisëse dhe atyre komunitare duke përfshirë detyrimet në shlyerjen e tarifës apo taksës mbi një shërbim të caktuar, detyrime nga të cilat në fakt duhet të mbulohet një pjesë e mirë e kostos së shërbimit përkatës.
2. Sjellja në raport me hedhjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e mjediseve publike: Shumë prej problemeve në rezultatet që priten nga një shërbim pastrimi i rregullt dhe efikas dhe që ndikojnë në rritjen e kostos për të, janë të ndikuara nga mungesa e respektimit të hedhjes së

mbeturinave në vendin e duhur dhe ndotja e mjediseve publike si rrugë, trotuare, kanale ujitëse, etj...

Në këtë kuadër procesi për pjesëmarrjen më aktive të komunitetit dhe komunikimin më të duhet të përqendrohet në:

- Realizimin e një vëzhgimi për vlerësimin e performancës së shërbimit të pastrimit, problemet, aktorët përgjegjës, situata aktuale, mundësitë për zgjidhje dhe kontributet e pritshme.
- Ngritja e grupit të punës me përfaqësuesit qytetar dhe organizimi i takimeve për diskutimet në lidhje me propozimet e planit të menaxhimit të mbeturinave dhe bashkëpunimit me të ngushtë me komunitetin.

Në të njëjten kohë janë identifikuar dhe 4 targe grupe të cilat duhet të përfshihen në planin e ndërgjegjësimit si dhe ndërhyrjet afatshkurtër dhe afatmesëm;

Komuniteti, biznesi, shkolla dhe media lokale janë aktorë që do të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të pastrimit në vitet në vijim.

Komponenti për ndërgjegjësimin qytetar do të përfshijë forma të ndryshme sensibilizimi në një plan afatshkurtër të tilla si:

- Realizimi dhe shpërndarja e fletëve informuese mbi itinerarin e grumbullimit të mbeturinave, hedhjen e tyre në vendet e caktuara, mirëmbajtjen në përdorim të kazanëve metalikë, ndarjen e mbeturinave inerte dhe hedhjen e tyre
- Realizimi dhe vendosja e posterave përmbajtësore në vendet publike më të frekuentuara
- Organizimi i takimeve me qytetarët për kryerjen e pagesës së tarifës së propozuar
- Organizimi i orëve të hapura në shkolla për çështje të mjedisit
- Realizimi i aksioneve vullnetare të pastrimit në zona të veçanta
- Realizimi i aksioneve masive për Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit (5 Qershor), Ditën e Qyteteve të Pastra (22 Shtator)

dhe në një plan afatmesëm:


- Organizimi dhe realizimi i sondazheve/anketave vjetore për matjen e performancës për shërbimin e pastrimit në veçanti dhe çështjeve të mjedisit në përgjithësi me synimin përfshirjen e opinionit qytetar në ndërmarrjen e veprimeve për rritjen e cilësisë së këtij shërbimi
- Organizimi i takimeve periodike me komunitetin për rritjen e tarifës në vite në raport me përmirësimin e cilësisë së shërbimit
- Rishikimi dhe vlerësimi i kurrikulës shkollore me synim futjen e edukimit mjedisor në vitet në vijim.
- Ngritja e grupeve mjedisore me nxënësit e shkollave dhe kabineteve përkatëse
- Identifikimi i nevojave për training të mësuesve në lidhje me edukimin mjedisor
- Kualifikimi i mësuesve dhe përditësimi i metodologjisë së edukimit mjedisor
- Ngritja e një grupi tematik mbi çështjet mjedisore me përfaqësues të grupeve të interesit
- Organizimi i takimeve konsultative të hapura

V. Konkluzione

- I. Kosto e shërbimit të pastrimit për rehabilitimin e situatës aktuale për dy fshatrat e komunës Guri i Zi (Guri i Zi dhe Juban) është afërsisht rreth 1,027,800 lekë.
- II. Kosto e shërbimit të pastrimit për shtatë fshatrat e komunës Guri i Zi sipas skenarit të parë - Konteniere metalikë me kapacitet 1.1 m³ dhe makinë teknologjike është 14,777,567 lekë/vit, ndërsa kosto operative 9,077,567 lekë në vit.
 - a. Tarifa e pastrimit për banorët sipas skenarit të parë është 2,086 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 2,607 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
 - b. Tarifa e pastrimit për bizneset sipas skenarit të parë është 25,400 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 31,700 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
 - c. Tarifa e pastrimit për institucionet sipas skenarit të parë është 6,900 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 8,600 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
- III. Kosto e shërbimit të pastrimit për shtatë fshatrat e komunës Guri i Zi sipas skenarit të dytë – pika grumbullimi të hapura dhe makinë e hapur për grumbullimin dhe depozitim në landfill është 10,748,993 lekë/vit, ndërsa kosto operative 8,408,997 lekë në vit.
 - a. Tarifa e pastrimit për banorët sipas skenarit të dytë është 1,900 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 2,400 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
 - b. Tarifa e pastrimit për bizneset sipas skenarit të dytë është 23,500 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 29,400 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
 - c. Tarifa e pastrimit për institucionet sipas skenarit të dytë është 6,400 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 8,000 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
- IV. Kosto e shërbimit të pastrimit për shtatë fshatrat e komunës Guri i Zi sipas skenarit të tretë – pika grumbullimi të hapura dhe makinë e hapur për grumbullimin dhe depozitim në vend depozitimin aktual është 7,869,567 lekë/vit, ndërsa kosto operative 5,529,567 lekë në vit.
 - a. Tarifa e pastrimit për banorët sipas skenarit të tretë është 1,300 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 1,600 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
 - b. Tarifa e pastrimit për bizneset sipas skenarit të tretë është 15,400 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 19,300 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.
 - c. Tarifa e pastrimit për institucionet sipas skenarit të tretë është 4,200 lekë në vitin 2009 dhe duhet të rritet deri në 5,300 lekë në vitin 2013 në mënyrë që të mbulojë koston operative.

Të gjitha konkluzionet e mësipërme paraqiten në mënyrë tabelare si më poshtë:

SKENARËT	KOSTO E PLOTË	KOSTO OPERATIVE	NIVELI I TARIFAVE	2009	2010	2011	2012	2013
KOSTO E REHABILITIMIT TË GJENDJES EKZISTUESE	1,027,800							
KONTENIERË METALIKË ME KAPACITET 1.1M3, MAKINË TEKNOLOGJIKE, DEPOZITIMI NË LANDFILLIN RAJONAL BUSHAT	14,777,567	9,077,567	FAMILJET	2,086	2,216	2,347	2,477	2,607
			BIZNESET	25,417	27,006	28,594	30,183	31,771
			INSTITUCIO NET	6,916	7,349	7,781	8,213	8,645
PIKA GRUMBULLIMI TË HAPURA, MAKINË E HAPUR PËR GRUMBULLIMIN, DEPOZITIMI NË LANDFILLIN RAJONAL BUSHAT	10,748,997	8,408,997	FAMILJET	1,932	2,053	2,174	2,295	2,415
			BIZNESET	23,545	25,017	26,488	27,960	29,431
			INSTITUCIO NET	6,407	6,807	7,208	7,608	8,009
PIKA GRUMBULLIMI TË HAPURA, MAKINË E HAPUR PËR GRUMBULLIMIN, DEPOZITIMI NË VEND DEPOZITIMIN AKTUAL	7,869,567	5,529,567	FAMILJET	1,271	1,350	1,429	1,509	1,588
			BIZNESET	15,483	16,450	17,418	18,386	19,353
			INSTITUCIO NET	4,213	4,476	4,740	5,003	5,266



VI. Rekomandime

Në funksion të analizave të këtij studimi, me qëllim përmirësimin e shërbimit të pastrimit, si dhe duke iu referuar eksperiencave pozitive të menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal, paraqitet më poshtë një përmbledhje e rekomandimeve të cilat komuna Guri i Zi duhet të marrë në konsideratë për marrjen e masave në fushat përkatëse që lidhen me sigurimin e një mjedisi të pastër dhe zbatimin me sukses të planit të menaxhimit të mbeturinave në zonat pilot me qëllim shtrirjen e mëtejshme të këtij shërbimi në mënyrë të përshkallëzuar edhe në fshatra të tjerë të saj.

Duke u nisur nga skenarët e analizuar më sipër rekomandimet qëndrojnë për marrjen në konsideratë dhe aplikimin e skenarit numër 1. Edhe pse skenari i tretë ofron kosto më të ulët të shërbimit të propozuar sipas kostove operative dhe atyre për investime, ndikimi i kësaj skeme është me pasoja në mjedis dhe po ashtu dhe në shëndetin publik të banorëve, pra impakti mjedisor dhe social është një element kyç për zgjedhjen e skenarit më të përshtatshëm.

Ndërkohë skenari i parë i propozuar për modernizimin e shërbimit me futjen në përdorim të makinës teknologjike dhe kontenierëve metalikë krijon lehtësi për një shërbim pastrimi efficient dhe me mundësi për rritje dhe qëndrueshmëri në të ardhmen. Në kuadër të një vlerësimi më vizionar impakti mjedisor dhe social i këtij skenari është mjaft pozitiv pasi ul ndjeshëm ndotjen dhe përhapjen e saj jashtë pikave të grumbullimit, redukon ndjeshëm rreziqet për infeksione nga mbeturinat pasi ato janë të izoluara dhe të mbyllura në kontenierë si dhe ul mundësinë për shpërhapjen e erërave të këqija në afërsi të shtëpive të banimit. Skenari i parë ofron mundësinë për standartizimin e shërbimit të pastrimit dhe konsolidimin e tij në të ardhmen.

Për sa më sipër është shpjeguar rekomandimet vijojnë për secilën fushë të ndërhyrjes:

Në Fushën Organizative

- Të përgatisë rregulloren e brendshme për shërbimin e pastrimit ku të përcaktohen detyrat dhe të drejtat e personelit (njësisë së mbledhjes së grumbullimit të mbeturinave
- Të respektojë vendosjen e pikave të grumbullimit sipas itinerarit të përcaktuar në hartë dhe në bashkëpunim me komunitetin vendas të negociojë për pika të caktuara
- Të sigurojë blerjen e kazanëve metalikë sipas studimit të bërë për këtë qëllim duke patur parasysh që t'i shërbehet edhe grupeve të vogla të banesave.
- Të hartojë e rishikojë grafikun e grumbullimit të mbeturinave duke përcaktuar ditët e pastrimit të rrugëve dhe të grumbullimit të mbeturinave
- Të vendosë në mënyrë periodike grafikun e shërbimit të pastrimit në vende të dukshme publike, me qëllim informimin e komunitetit (si psh tabela informative e komunës, afishime të ndryshme në shkolla dhe qendra komunitare apo shëndetësore)

Në Fushën Financiare

- Të kryejë llogaritjen e kostos operative të shërbimit të pastrimit duke patur parasysh 1) numrin e fuqisë punëtore, 2) parashikimin për rritjen e pagave sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin 2008, 3) shtimin e dy shërbimeve të tjera si: edukimi për publikun dhe shtyrje e sistem të mbeturinave sipas nevojës apo rastit të paraqitur.
- Të paraqesë dhe miratojë në Këshillin Bashkiak tarifën e pastrimit 1500 lekë/vit për familje për vitin 2009, duke përjashtuar familjet me ndihmë ekonomike
- Të paraqesë dhe miratojë në Këshillin e komunës tarifën për bizneset mesatarisht 10,070 lekë/vit dhe për institucionet mesatarisht 7,193 lekë/vit. (sipas tabelës).
- Të marrë masa organizative për arkëtimin e tarifës nga qytetarët
- Të miratojë në parim treguesit e tabelës ku janë paraqitur tendencat e rritjes së tarifave në vite si objektiva afatgjatë për realizim.

Në Fushën e Investimeve

- Të sigurojë blerjen e kazanëve metalikë të mbeturinave me kapacitet 1.1 m³ për t'i shpërndarë në territorin e fshatrave pilot sipas studimit të bërë për këtë qëllim. *Blerja e kontenierëve metaliek është e rekomandueshme si domosdoshmëri për të ulur koston dhe përmirësuar cilësinë e këtij shërbimi në të ardhmen*
- Të sigurojë fondet e nevojshme për blerjen e një makine teknologjike me qëllim futjen e proceseve teknologjike moderne për standartizimin e shërbimit të pastrimit si dhe për të mundësuar vënien në punë me efikasitet të plotë të kazanëve metalikë të mbeturinave.
- Të realizojë rehabilitimin e zonave të nxehta mjedisore duke ndërhyrë për heqjen e mbeturinave në pikat problematike të grumbullimit (kanalet kulluese dhe zonat përreth tyre si dhe gjatë rrugës kryesore)

Në Fushën Monitoruese

- Brenda vitit 2009 të realizohet sondazhi i parë për matjen e performancës së shërbimit të pastrimit për të vlerësuar opinionin e qytetarëve për shërbimin e pastrimit pas përmirësimeve të bëra.
- Në fillim të vitit 2010 stafi i komunës duhet të ndjekë procesin e mbushjes së kazanëve me mbeturina për të vlerësuar efikasitetin e përdorimit të tyre dhe riorganizimit të vendosjes së tyre në rast nevojë sipas situatës.
- Të rillogarisë kostot operative të proceseve të shërbimit të pastrimit (4-6 muaj pas fillimit të zbatimit të skemës së re), me qëllim krahasimin e faktit me planifikimin dhe për të marrë masa për uljen e mëtejshme të kostos pa prekur cilësinë e shërbimit të pastrimit.
- Të mas sasinë e mbeturinave që depozitohen në landfill duke marrë në konsideratë taksën që do të duhet të paguajë komuna për vend-depozitim të ri (landfill i Bushatit) në vitet në vijim
- Të përgatisë tabelën e treguesve të monitorimit të përcaktuar më sipër në planin e monitorimit

VII. Aneks

7.1 Aneks 1: Pamje nga Proçesi me Pjesëmarrje i hartimit të Planit të Menaxhimit të Mbeturive Urbane



Përcaktimi i pikave të grumbullimit



Takime me grupin e punës ngritur në komunë



Identifikimi i itinerarit dhe zonave të nxehta mjedisore



Gjaë punës në terren fëmijët dhe banorë të zonave afrohen për diskutime dhe informim



Përgatitja e hartave nga ekspertët e Co-PLAN



Vizita në venddepozitimin e mbetjeve



Gjatë vlerësimit të situatës së mbeturinave në qendrën shëndetësore



Realizimi i matjeve në terren për largësinë e pikave të grumbullimit në fshatrat pilot



Grupi i punës gjatë vizitës në venddepozitim ekzistues



Identifikimi dhe vlerësimi për rehabilitimin e gjendjes ekzistuese

7.2 Aneks 2: Harta e skemës së propozuar të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe venddepozitimit të mbeturive

(Itinerari i zbatimit të skemës, vendndodhja e pikave të grumbullimit, etj...)